



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. regjistri (JR) 6/2018
Datë 21.06.2018

Nr. vendimi (JR) 6
Datë 12.09.2018

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Trupi Gjykses i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, i përbërë nga:

Sokol Çomo	Kryesues
Albana Shtylla	Relator
Ardian Hajdari	Anëtar
Natasha Mulaj	Anëtar
Rezarta Schuetz	Anëtar

në praninë e Vëzhgueses Ndërkombëtare Mia LHE Roessingh-Bakels, asistuar nga Sekretare Gjyqësore Elba Arapi, në Tiranë, sot më datë 12.09.2018, ditë e mërkurë, ora 9:30, mori në shqyrtim në dhomë këshillimi, mbi bazë dokumentesh, ankimin që i përket Juridiksionit të Rivlerësimit, me të dhënat si më poshtë:

Ankues: Subjekti i rivlerësimit Besa Nikëhasani, Prokuror pranë Prokurorisë së Gjykatës së Apelit, Shkodër, përfaqësuar nga Avokati Arben Rakipi, me nr. licence 714.

Objekti i ankimit: Kundërshtimi i vendimit nr. 15, datë 20.04.2018, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

Baza ligjore e ankimit: Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenet A-F të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ndryshuar, neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Kodi i Procedurës Civile, Kodi i Procedurave Administrative, si dhe nenet 62, 63 e vijues të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ligji nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

TRUPI GJYKUES I KOLEGJIT TË POSAÇËM TË APELIMIT,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, ankimin e subjektit të rivlerësimit, i cili kërkoi ndryshimin e vendimit nr. 15, datë 20.04.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, si dhe pasi shqyrtoi gjithë dokumentacionin e nevojshëm në dhomë këshillimi, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

1. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (më poshtë Komisioni), me vendimin nr. 15, datë 20.04.2018, ka vendosur:
 - “1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, znj. Besa Nikëhasani, prokurore pranë Prokurorisë së Apelit Shkodër.
 2. Vendimi i arsyetuar, me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (më poshtë ligji nr. 84/2016).
 3. Ky vendim ankimohet pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit”.Subjekti i rivlerësimit e ka kundërshtuar këtë vendim, nëpërmjet ankimit të paraqitur brenda afatit ligjor, dhe Komisioni me vendimin nr. 15/1, datë 11.06.2018, ka vendosur pranimin e ankimit.

II. Shkaqet e ankimit

2. Subjekti i rivlerësimit, me ankimin e paraqitur kërkon nga Kolegji i Posaçëm i Apelit ndryshimin e vendimit nr. 15, datë 20.04.2018, të Komisionit dhe konfirmimin në detyrë, duke parashtruar këto shkaqe:
 - 2.1 Konkluzioni i Komisionit, për sa i takon tejkalimit të dyfishit të pasurisë së ligjshme, është nxjerrë jashtë seancës dëgjimore në shkelje të parimeve bazë të Kodit të Procedurave Administrative, si dhe të Kodit të Procedurës Civile, në shkelje të parimeve kushtetuese dhe të KEDNJ-së. Komisioni nuk ia ka nënshtruar debatit gjyqësor konstatimin se subjekti tejkalon dyfishin e pasurisë së ligjshme, duke shkelur parimin e kontradiktoritetit, barazisë së armëve dhe standardin e arsyetimit të vendimeve, si dhe standardet e GJEDNJ-së për një proces të drejtë. Fakti që “nuk justifikon me të ardhura të ligjshme pasurinë”, i është komunikuar vetëm në seancë dëgjimore, duke bërë që procesi të jetë i pavlefshëm dhe i parregullt ligjor.
 - 2.2 Konkluzioni i nxjerrë nga Komisioni është në shkelje të procedurës, pasi nuk ka asnjë element procedural për arritjen e tij. Trupi gjyqësor i Komisionit nuk është ekspert kontabël dhe ekonomik në tërësi dhe, për këtë arsye, nuk mund të marrë rolin e ekspertit për të bërë vlerësimin ekonomik dhe kontabël të pasurisë së subjektit të rivlerësimit, rol të cilin sipas ligjit të rivlerësimit e luajnë profesionistët e ILDKPKI-së. Komisioni nuk ka arsyetuar arsyet e kundërshtimit të raportit pozitiv dhe të saktë të ILDKPKI-së, prandaj Komisioni duke e hedhur

poshtë këtë raport ka vepruar në kundërshtim me dispozitat procedurale që rregullojnë këtë çështje.

- 2.3 Sipas nenit D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës, deklarata e pasurisë për efekt të procesit të rivlerësimit është dokumenti i vetëm i mjaftueshëm për të arritur në marrjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra të subjektit të rivlerësimit. Marrja nga Komisioni e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra, bazuar mbi pasaktësitë e ndryshme në deklaratat e bëra ndër vite prej subjektit të rivlerësimit, është kapërcim i mundësisë që ligji i ka dhënë në këtë rast, kur ILDKPKI-ja është shprehur ndryshe.
- 2.4 Për shkak se nuk është bërë e njohur lënda në shqyrtim, nuk është debatuar në seancë tejkalimi i dyfishit të pasurisë së ligjshme, vlerësimi ekonomik dhe kontabël është bërë nga trupi gjykues që ka hetuar rreth këtij fakti të padebatuar në seancë dhe vendimi i ankimuar ka elemente të theksuara të paragjykimit, është shkelur parimi i gjykimit nga një gjykatë e pavarur.
- 2.5 Dhënia e konkluzionit se subjekti tejkalon dyfishin e pasurisë së ligjshme vetëm në vendimin e Komisionit, prek standardin e arsytimit të vendimeve.
- 2.6 Konkluzioni i nxjerrë nga Komisioni se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarim të pamjaftueshëm për kontrollin e pasurisë është i gabuar, pasi subjekti ka kryer vetëm pasaktësi teknike dhe të paqëllimshme, të kryera jo me dashje, por si rezultat i ndikimit të faktorëve njerëzorë, si: harresa apo mosnjohja e legjislacionit të ri për deklarimin e pasurisë. Masa disiplinore e dhënë është joproporcionale, pasi ka kapërcyer qëllimin e ligjit, duke mos qenë në përputhje me nenin 61, pika 3 dhe nenin 33 të ligjit nr. 84/2016. Trupi gjykues ka vepruar në doza të larta paragjykimi pasi nuk ka vlerësuar raportet e institucioneve të inteligjencës dhe atyre të vlerësimit profesional, të cilat duhet të jenë pozitive, për sa kohë nuk janë debatuar në seancë dëgjimore.
- 2.7 Në vendimin e Komisionit është përfshirë si shkelje e etikës prej subjektit të rivlerësimit, qëndrimi emocional, në përfundim të seancës dëgjimore, duke faktuar kështu qëndrimin paragjykues të trupit gjykues.
- 2.8 Konstatimi i trupit gjykues në lidhje me mosdeklarimin nga subjekti i rivlerësimit, në deklaratën e pasurisë (*vetting*) 2017 të pronësisë së dy garazheve me sipërfaqe 21,1 m² dhe 19,2 m², është i gabuar dhe paragjykues, pasi rezulton tërësisht e provuar se bashkëlidhur deklaratës, është depozituar pranë ILDKPKI-së edhe aktmarrëveshja e datës 04.12.2009, e lidhur me {***} SHPK, në të cilën parashikohet qartë edhe blerja e dy garazheve në çmimin total të deklaruar prej 90.000 eurosh, duke përmbushur kështu detyrimin për të deklaruar pasuritë në pronësi.
- 2.9 Konkluzioni i Komisionit se subjekti i rivlerësimit ka përdorur deklaratë të rreme për të justifikuar me burim të ligjshëm të ardhurash pasurinë e blerë, apartament me sip. 144,79 m², adresa rr. {***}, Tiranë, është i gabuar, pasi deklarata noteriale e shtetases M.N. nr. 3648 rep., nr. 2276 kol., datë 22.08.2013, për dhurimin e shumës 752.880 lekë djalit të saj A.N., është në përputhje me dy kontratat e shitblerjes së vitit 2008 (të sipërcituara) dhe këto të ardhura janë përfituar në vitin 2008. Në lidhje me sa shprehet deklarata noteriale për kohën e dhurimit të parave, ka një lapsus të bërë nga noteri publik.
- 2.10 Qëndrimi i Komisionit është paragjykues, pasi nuk qëndron arsyetimi i tij ligjor se nëse subjekti do të donte të provonte dhurimin e shumës, të përfituar nga shitja e tokës nga ana e

vjehrrës me kontratat e vitit 2008, do të duhej të përfshinte edhe të ardhurat e përfituara nga shitja e një cope tokë tjetër me kontratën e shitblerjes së pasurisë së paluajtshme nr. 546 rep., nr. 438/3 kol., datë 15.02.2010, për shumën 502.000 lekë.

- 2.11 Konkluzioni i Komisionit se subjekti nuk justifikon me të ardhura të ligjshme diferencat e shumave të deklaruara si kursime për periudhën 2007-2011 është i gabuar, pasi mënyra e përlogaritjes së Komisionit përbën një gabim material në paraqitjen e një bilanci, ku mungon analiza e të ardhurave dhe e shpenzimeve të subjektit deklarues.
- 2.12 Konkluzioni i Komisionit se subjekti i rivlerësimit përdor çdo kontratë shitjeje të kryer nga personat e tjerë të lidhur si burim të ardhurash, është i gabuar, pasi në deklaratimet periodike vjetore janë përdorur vetëm kontratat e shitjes të kryera nga nëna e bashkëshortit (për pjesën takuese të bashkëshortit dhe të nënës së tij), e cila ka jetuar së bashku me familjen e subjektit të rivlerësimit deri në vitin 2011.
- 2.13 Qëndrimi i Komisionit, i cili nuk ka marrë në konsideratë deklaratën noteriale të deklaruesve M. N.; P. N. dhe F. Sh., të cilët legjitimojnë veprimet e kryera në vitin 2002 e 2003, se i kanë dhuruar bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit shumën 2.100.000 lekë është paragjykses, pasi nuk mund të jetë mision i trupit gjykues vënia në dyshim e vullnetit të shfaqur para noterit publik. Shuma prej 2.100.000 lekësh nuk është deklaruar në deklaratën e pasurisë *vetting* 2017, pasi apartamenti në rrugën {***}, Lezhë, është i prishur tashmë.
- 2.14 Konkluzioni i Komisionit se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti i saj janë sjellë si pronarë të ligjshëm të apartamentit të prishur në rrugën {***}, Lezhë, duke lidhur aktmarrëveshje dhe kontratë shkëmbimi për të, edhe pse nuk kanë pasur pronësinë ligjore të vërtetuar me dokument zyrtar, është i gabuar, pasi pavarësisht mungesës së formalizimit të veprimit juridik të kalimit të pronësisë, në shkëmbimin e kësaj pasurie palët janë bazuar në legjislacionin në fuqi në momentin e kryerjes së veprimit juridik, në nenin 83 e vijues të Kodit Civil, si dhe në nenin 757 të tij.
- 2.15 Arsyetimi i Komisionit se aktmarrëveshja nr. 860 rep., nr. 652 kol., datë 17.03.2011, me shoqërinë {***} SHPK përmban të dhëna të rreme, është i gabuar, pasi ajo ka qenë një marrëveshje verbale paraprake *de facto*, e lidhur mes palëve në vitin 2010, kur është kryer edhe pagesa prej 25.000 eurosh, ndërsa me aktmarrëveshjen e shkëmbimit me shoqërinë {***} SHPK, në vitin 2011, është formalizuar marrëveshja e mëparshme.
- 2.16 Qëndrimi i Komisionit është paragjykses dhe në shkelje të parimit të prezumimit të pafajësisë, kur konstaton se i lind “dyshimi i arsyeshem” për një veprim financiar të pajustificuar, pasi autovetura “Toyota Land Cruiser”, viti i prodhimit 2012, i është shitur subjektit të rivlerësimit me një çmim më të ulët nga sa i ka kushtuar shitësit në të vërtetë. Diferenca në çmim është pasojë e defekteve të makinës.
- 2.17 Konkluzioni i Komisionit se ka fshehje të të ardhurave ose të ardhura të krijuara nga burim i paligjshëm, për shumën 4.000 euro nga shitja e autoveturës së vjetër është i gabuar, pasi subjekti i rivlerësimit ka provuar me deklaratë noteriale, por edhe me parashikimet kontraktore se autovetura është shitur para blerjes së autoveturës së re, por formalizimi është bërë në një periudhë të mëvonshme.
- 2.18 Në kundërshtim nga sa ka konkluduar Komisioni, shtetasi A.M. ka mundësi financiare për t’i dhënë hua subjektit të rivlerësimit, në shumën 12.000 euro.

- 2.19** Qëndrimi i Komisionit, i cili nuk merr parasysh deklaratimet e personave para noterit publik, duke mos i dhënë kështu nivelin e provueshmërisë, madje duke analizuar një transaksion tjetër, atë mes huadhënësit dhe palëve të treta, është tërësisht i njëanshëm dhe në shkelje të hapur të parimeve bazë, të procedurave të ndjekura dhe lirive e të drejtave themelore të njeriut.
- 2.20** Konkluzioni i Komisionit se subjekti i rivlerësimit ka kryer fshehje të pasurisë në shumën prej 200.000 lekësh dhe ka kryer deklaram të rremë në lidhje me huadhënien prej 300.000 lekë, është i gabuar, pasi qëllimi nuk ka qenë fshehja e pasurisë, por siç është pranuar në vazhdimësi prej tij, mosdeklarimi i tyre është pasojë e harresës.
- 2.21** Në kundërshtim nga sa ka konkluduar Komisioni, subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar më shumë se dyfishi i pasurisë së ligjshme, gjatë vlerësimit të pasurisë, duke përfshirë dhe personat e lidhur me të.

III. Rrethanat e çështjes

3. Subjekti i rivlerësimit Besa Nikëhasani ka ushtruar detyrën e Prokurorit që nga viti 1993 dhe në vazhdim, u është nënshtruar procedurave të rivlerësimit me përparësi, me shortin e hedhur nga Komisioni më datë 30.11.2017, si kandidate për anëtare e Këshillit të Lartë të Prokurorisë.
4. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera lidhur me këtë subjekt të rivlerësimit, ILDKPKI-ja, në raportin e saj ka konstatuar se:
 “Deklarimi është i saktë dhe në përputhje me ligjin.
 Ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë.
 Nuk ka kryer fshehje të pasurisë.
 Nuk ka kryer deklaram të rremë.
 Nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesit.”
5. Komisioni ka përfunduar hetimin administrativ vetëm për kriterin e vlerësimit të pasurisë. Me vendimin nr. 15, datë 20.04.2018, Komisioni ka konkluduar se:
 “Subjekti i rivlerësimit, Besa Rexhep Nikëhasani, rezulton të ketë deklaruar më shumë se dyfishi i pasurisë së ligjshme gjatë vlerësimit të pasurisë, përfshirë edhe personat e lidhur me të:
 - apartament banimi në Shëngjin, Lezhë, me burim të pajustificuar, subjekti nuk ka pasur asnjëherë dokument pronësie për apartamentin në rr. {***}, të cilin pretendon ta ketë shkëmbyer me shumën 25.000 euro;
 - njësi shërbimi 150 m² në rr. {***}, Lezhë, me burim të pajustificuar, subjekti nuk ka pasur asnjëherë dokument pronësie për apartamentin në rr. {***}, të cilin pretendon ta ketë shkëmbyer me këtë njësi shërbimi;
 - apartament banimi në rr. {***}, Tiranë, me burim të pajustificuar, në shumën 2.029.700 lekë;
 - autoveturë tip “Toyota Land Cruiser”, me burim të pajustificuar në shumën 2.164.320 lekë, pasi rezulton se z. A. M. nuk ka aftësi paguese për të justifikuar dhënien e një huaje në vlerën 12.000 euro dhe subjekti i rivlerësimit ka mungesë të dokumentacionit ligjor për të justifikuar burimin e shumës 4.000 euro për blerjen e automjetit.
 Subjekti i rivlerësimit Besa Rexhep Nikëhasani rezulton se ka kryer deklaram të pamjaftueshëm për kontrollin e pasurisë, sepse:
 - deklarimi nuk është i saktë dhe në përputhje me ligjin. Subjekti në mënyrë të përsëritur pranon të ketë gabime dhe pasaktësi në deklarime, duke i konsideruar ato lapsuse;

- nuk ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;
- ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për pasuritë që ka në pronësi, mungesë të dokumentacionit ligjor për pronësinë e këtyre burimeve të pretenduara;
- ka kryer fshehje të pasurisë në shuma të vogla;
- ka kryer deklaram të rremë në mënyrë të përsëritur, duke u përpjekur të justifikojë veprimet e viteve të mëparshme me deklarata noteriale të sapohartuara.”

VLERËSIMI I TRUPIT GJYKUES TË KOLEGJIT TË POSAÇËM TË APELIMIT

6. Juridiksioni i Rivlerësimit dhe kompetenca e Kolegjit të Posaçëm të Apelitit përcaktohen në nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës, e cila parashikon: “Rivlerësimi kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, ndërsa ankimet e subjekteve të rivlerësimit ose të Komisionerit Publik shqyrtohen nga Kolegji i Apelitit pranë Gjykatës Kushtetuese.”, si dhe në nenin 5, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016, sipas të cilave: “1. Procesi i vlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Apelitit, komisionerët publikë, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë. 2. Kolegji i Apelitit shqyrton ankimet ndaj vendimeve të Komisionit dhe ka mandat 9-vjeçar.”
Procesi gjyqësor në Kolegjin e Posaçëm të Apelitit zhvillohet bazuar në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016, në përputhje me rregullat e parashikuara në nenet 47, 48/1, 49, 51 dhe 55 të ligjit nr. 49/2012.
7. Subjekti i rivlerësimit Besa Nikëhasani legjitimohet *ratione personae* në kuptim të nenit F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës dhe *ratione temporis* në kuptim të nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016. Ankimi kundër vendimit nr. 15, datë 20.04.2018, të Komisionit, rezulton të jetë i plotë edhe në elementet e tjera, si të formës edhe të përmbajtjes.
8. Në analizë të akteve e provave shkresore mbi të cilat Komisioni ka bërë vlerësimin e subjektit të rivlerësimit Besa Nikëhasani, si dhe nga shqyrtimi në tërësi i të gjithave shkaqeve të parashtruara në ankim, Kolegji i Posaçëm i Apelitit vlerëson se vendimi nr. 15, datë 20.04.2018, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit është bazuar në kriteret e përcaktimeve kushtetuese dhe ligjore të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 61, pikat 1 dhe 3 të ligjit nr. 84/2016. Ky vendim konstatohet të jetë rrjedhojë e një procesi të rregullt ligjor, në garantim të të drejtave të subjektit të rivlerësimit, në përputhje me parimet e ligjshmërisë e proporcionalitetit dhe një analize të plotë e të drejtë të gjendjes faktike, provave dhe ligjit, për rrjedhojë, pretendimet e paraqitura në ankim janë të pabazuara.

III. Analiza e shkaqeve të ankimit për shkeljet procedurale të pretenduara

9. Subjekti i rivlerësimit ka paraqitur së bashku me ankimin këto akte shkresore, të cilat ka kërkuar të merren në cilësinë e provës:
 - a) shkresë nr. 4379 prot., datë 01.06.2018, e Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Lezhë, e cila ka bashkëlidhur kartelat e pasurisë së paluajtshme tokë bujqësore në pronësi të shtetas M. N.;
 - b) shkresë nr. 4318 prot., datë 31.05.2018, e Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Bashkia Lezhë;
 - c) shkresë nr. 889 prot., datë 28.05.2018, e Ujësjetllës Kanalizime SHA, Lezhë;

c) formularë të Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike;

d) raport i audituesit ligjor me titull “Raporti i audituesit të pavarur mbi dokumentacionin ekonomik-financiar si dhe deklaratimet e pasurisë të znj. Besa Nikëhasani - subjekt i rivlerësimit para Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, në zbatim të ligjit nr. 84/2016”, hartuar nga Sh. M., auditues ligjor me licencë profesionale nr. 178.

9.1 Trupi gjykues, me vendim të ndërmjetëm, vendosi të mos i marrë dhe administrojë aktet e paraqitura së bashku me ankimin, në cilësinë e provës në gjykim, pasi ato nuk plotësonin kushtet e përcaktuara në nenin 47 të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar (më poshtë ligji nr. 49/2018) dhe në nenin 49, pika 6, shkronjat “b” dhe “d” të ligjit nr. 84/2016. Subjekti i rivlerësimit, në ankim nuk ka paraqitur asnjë arsye në përmbushje të kushteve ligjore si më sipër, se përse nuk mundi t’i paraqiste këto prova gjatë shqyrtimit të çështjes në Komision, kur nga ky i fundit, në mënyrë të vazhdueshme dhe brenda afateve të arsyeshme, i është kërkuar të paraqesë dokumentacion justifikues në lidhje me pasuritë. Marrja e provave të reja u refuzua edhe sepse, nga vlerësimi i përmbajtjes së tyre, rezultoi se edhe nëse do të konsideroheshin të vërteta, faktet që subjekti i rivlerësimit kërkonte të provonte nëpërmjet tyre u konsideruan të parëndësishme dhe nuk do të ndikonin në marrjen e vendimit.

10. Bashkëlidhur parashtrimeve, 5 ditë përpara shqyrtimit të çështjes në dhomë këshillimi, subjekti i rivlerësimit paraqiti këto akte:

- a) deklaratë noteriale nr. 3138 rep., nr. 2170 kol., datë 31.08.2018, e shtetasve A. N. dhe A. M.;
- b) urdhërpagesë Banka Credins, Lezhë, datë 31.08.2018, në vlerën 8.000 euro, urdhërues A. N. në favor të A. M.

10.1 Aktet e paraqitura bashkëlidhur parashtrimeve, 5 ditë përpara shqyrtimit të çështjes në dhomë këshillimi nuk u pranuan në cilësinë e provës, pasi bazuar në nenin 49, pika 2 e ligjit nr. 49/2012, palët mund të paraqesin vetëm parashtrime me shkrim lidhur me shkaqet e ngritura në ankim, por kjo dispozitë në çdo rast, nuk lejon shtim të shkaqeve të ankimit ose paraqitjen e fakteve dhe provave të reja në këtë fazë të procesit. Në këto parashtrime me shkrim ankuesi mund të japë vetëm sqarime plotësuese në lidhje me përmbajtjen e ankimit dhe vetëm për shkaqet e kundërshtimit të vendimit të ngritura brenda afatit të parashikuar nga neni 63 i ligjit 84/2016.

11. Trupi gjykues, me vendim të ndërmjetëm, vendosi të vazhdojë shqyrtimin e çështjes në dhomë këshillimi, mbi bazë dokumentesh, pasi arriti në konkluzionin se nuk plotësohet asnjë nga kërkesat e nenit 51 të ligjit nr. 49/2012, për shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore në prani të palëve.

12. *Lidhur me pretendimin në ankim se konkluzioni i Komisionit, për sa i takon tejkalimit të dyfishit të pasurisë së ligjshme, është nxjerrë jashtë seancës dëgjimore në shkelje të parimeve bazë të Kodit të Procedurave Administrative si dhe të Kodit të Procedurës Civile, në shkelje të parimeve kushtetuese dhe të KEDNJ-së dhe standardeve të GJEDNJ-së për një proces të drejtë dhe se fakti që “nuk justifikon me të ardhura të ligjshme pasurinë” i është komunikuar vetëm në seancë dëgjimore, duke bërë që procesi të jetë i pavlefshëm dhe i parregullt ligjor, trupi gjykues konstaton se:*

Komisioni, pas nisjes së procedurës së hetimit, nëpërmjet e-mail-it në adresën zyrtare të subjektit të rivlerësimit, në datat 31.01.2017 dhe 13.02.2018, i ka kërkuar këtij të fundit të japë të dhëna dhe

të paraqesë prova, në lidhje me problematika të gjetura në deklarinimin e pasurisë së rivlerësimit dhe deklarimeve periodike vjetore. Subjekti i rivlerësimit, në datat 08.02.2018 dhe 20.02.2018, u është përgjigjur këtyre kërkesave, duke paraqitur edhe provat përkatëse. Komisioni, me vendimin nr. 02, datë 13.03.2018 ka përfunduar hetimin paraprak për subjektin dhe e ka njoftuar për kalimin e barrës së provës, për secilin prej konstatimeve në rezultatet e hetimit paraprak, bazuar në nenin D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenin 52 të ligjit nr. 84/2016. Pas njohjes me dosjen, subjekti ka paraqitur shpjegimet mbi rezultatet e hetimit administrativ, më datë 03.04.2018, duke bashkëlidhur provat në mbështetje të tyre. Në seancën dëgjimore në Komision, datë 17.04.2018, relatorja e çështjes ka prezantuar rezultatet e hetimit, të njëjta me ato që i ishin bërë të njohura subjektit me anë të vendimit nr. 02, datë 13.03.2018, të Komisionit. Subjekti i rivlerësimit ka paraqitur shpjegimet dhe provat mbi konstatimet e Komisionit, ndër të tjera edhe për mosjustifikimin me të ardhura të ligjshme të kursimeve dhe në fund deklaroi se pasuria e tij është e justifikuar me burime të ligjshme.

Për sa i përket konstatimit të tejkalimit të dyfishit të pasurisë së ligjshme, ky përfundim i Komisionit ka ardhur si rezultat i vlerësimit të të gjitha të dhënave të mbledhura gjatë hetimit me të cilat subjekti është njohur në çdo fazë të tij, si dhe i vlerësimit të të gjitha shpjegimeve dhe provave të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit. Vendimi i Komisionit se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar më shumë se dyfishin e pasurisë së ligjshme vjen si pasojë e analizës ligjore dhe ekonomike të të gjitha pasurive të subjektit të rivlerësimit dhe vetëm pas ezaurimit të të gjitha mundësive të të provuarit prej vetë subjektit të rivlerësimit, pas kalimit të barrës së provës, se i justifikon pasuritë me burim të ligjshëm. Këtë të drejtë dhe mundësi, subjekti i rivlerësimit e ka edhe gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore publike. Vetëm në përfundim të procesit të rivlerësimit, Komisioni mund të konkludojë në lidhje me tejkalimin e dyfishit të pasurisë së ligjshme nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të.

Sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se Komisioni i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës për justifikimin me të ardhura të ligjshme të pasurisë dhe tejkalimin e dyfishit të pasurisë së ligjshme, bazuar në nenin D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

13. *Lidhur me pretendimin në ankim se konkluzioni i nxjerrë nga Komisioni se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar më shumë se dyfishin e pasurisë së ligjshme është në shkelje të procedurës, pasi trupi gjykues i Komisionit nuk është ekspert kontabël dhe ekonomik në tërësi dhe për këtë arsye nuk mund të marrë rolin e ekspertit, rol të cilin sipas ligjit të rivlerësimit e luajnë profesionistët e ILDKPKI-së dhe se Komisioni duke kundërshtuar raportin e ILDKPKI-së ka vepruar në kundërshtim me dispozitat procedurale që rregullojnë këtë çështje, trupi gjykues arsyeton se:*

Organet e rivlerësimit janë organe kushtetuese me kompetenca të përcaktuara në nenin 179/b të Kushtetutës dhe në Aneksin e saj. Në nenin 179/b, pika 5 përcaktohet se rivlerësimi kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, ndërsa ankimet e subjekteve të rivlerësimit ose të Komisionerit Publik shqyrtohen nga Kolegji i Posaçëm i Apelimit, duke parashikuar kështu kompetencën bazë, ekskluzive të Komisionit që është kryerja e procesit të rivlerësimit. Ligji nr. 84/2016 përcakton procedurat dhe garancitë e ushtrimit të kompetencave të organeve të rivlerësimit. Në nenin 4, pika 1 ky ligj përcakton se procesi i rivlerësimit kryhet mbi bazën e tri kritereve: vlerësimi i pasurisë, kontrolli i figurës dhe vlerësimi i aftësive profesionale, ndërsa në nenin 45, pika 1 në drejtim të përcaktimit të rregullave të hetimit të çështjes përcakton se organet e rivlerësimit hetojnë dhe vlerësojnë të gjitha faktet dhe rrethanat e nevojshme për procedurën e rivlerësimit. Në këtë kuptim, procesi i rivlerësimit është detyrë e Komisionit, të cilën ai e ushtron nëpërmjet trupave gjyquese.

Në ushtrimin e kompetencave të tij, Komisioni mbështetet edhe nga Njësia e Shërbimit Ligjor, e cila përbëhet nga këshilltarë ligjorë dhe ekonomikë¹. Procesi i rivlerësimit për kriterin e pasurisë nuk është një proces vlerësimi strikt financiar, por një balancë mes interpretimit ligjor dhe analizës financiare për ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive dhe përmbushjes së detyrimeve financiare të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të.

Sa më sipër, del qartë se Kushtetuta dhe ligji e kanë pajisur Komisionin me të gjitha kompetencat e nevojshme për marrjen e vendimeve bazuar në një proces hetimi të plotë, në analizën e saktë dhe shteruese të provave të mbledhura dhe në zbatim të parimeve të procesit të rregullt ligjor.

Raporti mes kompetencave të ILDKPKI-së si organ ndihmës dhe atyre të Komisionit si organ vendimmarrës është një çështje e interpretuar nga vendimi nr. 2/2017 i Gjykatës Kushtetuese, i cili ka bërë interpretimin pajtues të ligjit nr. 84/2016 me Kushtetutën, duke u shprehur: “Duke bërë një interpretim të tillë të këtyre dispozitave ligjore konkludohet se edhe në këtë rast ligji nuk e ka zhvendosur kontrollin dhe hetimin tek organet ekzistuese dhe ato nuk kanë marrë dhe as nuk ushtrojnë kompetencat që u njihen organeve të reja kushtetuese. Kjo dispozitë lejon që këto institucione të hetojnë në mënyrë të pavarur për të gjitha rrethanat e çështjes. Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse.”²

Për sa më sipër trupi gjykues vlerëson se Komisioni ka vepruar në përputhje me ligjin nr. 84/2016 dhe vendimin nr. 2 të Gjykatës Kushtetuese, kur, përtej raportit të ILDKPKI-së, ka kryer hetimin administrativ mbi kontrollin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit.

14. *Lidhur me pretendimin në ankim se konsiderimi prej Komisionit i pasaktësive të ndryshme në deklaratat e bëra ndër vite prej subjektit të rivlerësimit, si shkak për marrjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra, është kapërcim i mundësisë që ligji i ka dhënë në këtë rast, kur ILDKPKI-ja është shprehur ndryshe, trupi gjykues arsyeton se:*

Bazuar në përcaktimet e nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe neneve 30 dhe 32, pikat 1 dhe 5 të ligjit nr. 84/2016 rezulton se deklarata e pasurisë për procesin e rivlerësimit, nuk është dokumenti i vetëm i mjaftueshëm për vendimmarrjen e Komisionit, por deklaratimet e interesave privatë dhe pasurorë, të paraqitura më parë tek ILDKPKI-ja mund të përdoren si provë prej tij. Deklarimet e mëparshme të pasurisë, të kryera nga subjekti i rivlerësimit përbëjnë edhe bazën e vlerësimit krahasues për ILDKPKI-në, për përgatitjen e raportit përfundimtar, bazuar në nenin 33, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, e cila përcakton: “1. ILDKPKI-ja, bazuar në deklaratimet e pasurive, zhvillon një procedurë të plotë kontrolli në përputhje me këtë ligj, ligjin “Për deklarinimin dhe kontrollin e pasurive, detyrimeve financiare të personave të zgjedhur dhe nëpunësve të caktuar publikë”, ligjin “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” dhe Kodin e Procedurave Administrative”. Subjekti i rivlerësimit, në ankim, e pranon kontrollin dhe krahasimin e të dhënave të deklaratimeve të mëparshme prej ILDKPKI-së, ndërkohë që kryerjen e të njëjtit proces prej Komisionit e konsideron si në kundërshtim me përcaktimet kushtetuese dhe ligjore. Bazuar në vendimin nr. 2/2017 të Gjykatës Kushtetuese, Komisioni heton në mënyrë të pavarur për të gjitha rrethanat e çështjes dhe kryen një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi pa u bazuar dhe pa qenë i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga ILDKPKI-ja. Në këtë kuptim,

¹ Neni 22 i ligjit nr. 84/2016.

² I njëjti qëndrim është shprehur edhe në opinionin CDL-AD (2016)036 të Komisionit të Venecias.

Komisioni përdor të njëjtën bazë vlerësimi si ILDKPKI-ja: deklaratën e pasurisë (*vetting*) 2017 të krahasuar me deklaratat periodike të pasurisë ndër vite, të subjektit të rivlerësimit.

Në kuadër të procesit të rivlerësimit shkarkimi i gjyqtarit, ashtu si në rastet e tjera të parashikuara nga Kushtetuta, kryhet nga Komisioni pas një procesi hetimi të bazuar në prova, të cilat sipas nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016 mund të jenë edhe deklaratimet e interesave privatë dhe pasurorë, të paraqitur më parë tek ILDKPKI-ja. Kontrolli i deklaratës së pasurisë për procesin e rivlerësimit dhe krahasimi i saj me deklaratimet e mëparshme, i shërben Komisionit për të ndjekur ecurinë dhe vërtetësinë e deklarimeve të subjektit, në lidhje me pasurinë e deklaruar dhe për të nxjerrë konkluzionet mbi ligjshmërinë e pasurisë së subjektit apo mjaftueshmërinë e deklarimeve të tij.

Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se Komisioni ka vepruar në përputhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjin nr. 84/2016 dhe për këtë arsye pretendimi i subjektit është i pabazuar.

15. *Lidhur me pretendimin në ankim se për shkak se nuk është bërë e njohur lënda në shqyrtim, nuk është debatuar në seancë tejkalimi i dyfishit të pasurisë, vlerësimi ekonomik dhe kontabël është bërë nga trupi gjykues që ka hetuar rreth këtij fakti të padebatuar në seancë dhe vendimi i ankimit ka elemente të theksuara të paragjyqimit, nga Komisioni është shkelur parimi i gjyqimit nga një gjykatë e pavarur, trupi gjykues vlerëson se:*

Pretendimit të subjektit të rivlerësimit i jepet përgjigje nëpërmjet vendimit të Gjykatës Kushtetuese nr. 2/2017 dhe Opinioni *CDL-AD (2016)036* të Komisionit të Venecias për ligjin nr. 84/2016.

Vendimi nr. 2/2017 i Gjykatës Kushtetuese shprehet: “Për nga mënyra se si është konceptuar i gjithë sistemi i rivlerësimit në Kushtetutë, pra organet që e kryejnë atë, mënyra e zgjedhjes së anëtarëve të tyre dhe garancitë që ata gëzojnë, kompetencat që këto organe do të ushtrojnë dhe baza ligjore ku mbështetet kjo veprimtari, vlerësohet se këto organe ofrojnë të gjitha garancitë që kërkon e drejta për një proces të rregullt gjyqësor në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së.”

Ndërsa Opinioni *CDL-AD (2016)036* i Komisionit të Venecias shprehet: “Nga dispozitat kushtetuese dhe legislative duket se organet e rivlerësimit, pra Komisioni i Pavarur dhe Kolegji i Apelimit kanë të dy karakteristikat e organeve gjyqësore. Sipas nenit 179(b)6, të dy këto organe operojnë dhe marrin vendime në mënyrë të pavarur dhe të paanshme. Sipas nenit C të Aneksit të Kushtetutës, gjatë mandatit të tyre, anëtarët e Komisionit të Pavarur dhe Komisionerit Publik gëzojnë statusin e gjyqtarit të Gjykatës së Lartë (paragrafi 3). Kolegji i Apelimit funksionon pranë Gjykatës Kushtetuese (neni 179(b)5 i Kushtetutës) dhe anëtarët e tij gëzojnë statusin e gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese (neni C(3) i Aneksit). [...] Në këndvështrimin e Komisionit të Venecias, organet e tjera siç janë ILDKPKI ose DSIK, të cilat janë të përfshira në procesin e *vetting*-ut, duket se kanë funksione ndihmëse dhe instrumentale që kanë për qëllim të ndihmojnë institucionet e reja në përmbushjen e mandatit të tyre të vështirë. Në të gjitha rastet, autoritetet vendimmarrëse duket se mbeten te Komisioni i Pavarur dhe Kolegji i Apelimit, të krijuara për këtë qëllim në përputhje me dispozitat e Kushtetutës, si organe gjyqësore të pavarura dhe të paanshme.”

Trupi gjykues vlerëson se Komisioni ka të gjitha kompetencat kushtetuese dhe ligjore për të hetuar dhe vlerësuar rrethanat dhe faktet e nevojshme për procedurën e rivlerësimit, në rastin konkret për kriterin e vlerësimit të pasurisë, pa qenë të ndikuar nga raportet e organeve ndihmëse dhe në mënyrë të pavarur prej tyre. Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se nuk është prekur parimi i gjykatës së pavarur.

16. *Në lidhje me pretendimin në ankim se dhënia e konkluzionit se subjekti tejkalon dyfishin e pasurisë së ligjshme vetëm në vendimin e Komisionit, prek standardin e arsytimit të vendimeve, trupi gjykues arsyeton se:*

Vendimi nr. 15, datë 20.04.2018, i Komisionit i përmban të gjitha elementet e përcaktuara në nenin 57 të ligjit nr. 84/2016 dhe në jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese³. Për sa i përket konstatimit të tejkalimit të dyfishit të pasurisë, ky përfundim i Komisionit ka ardhur si rezultat i vlerësimit të të gjitha shpjegimeve dhe provave të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, të të gjitha të dhënave të mbledhura gjatë hetimit, me të cilat subjekti është njohur në çdo fazë të hetimit deri në përfundim të tij. Arsytimi i këtij konkluzioni është rrjedhojë logjike e arsytimit të vendimit për secilën pasuri më vete. Për secilën pasuri, përfundimet e Komisionit janë dhënë në mënyrë të qartë, bazuar në rezultatet e hetimit dhe në vlerësimin prej tij të shpjegimeve dhe provave të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit. Pjesët përbërëse të këtij vendimi, në lidhje me vlerësimin për secilën pasuri, lidhen ngushtësisht me rezultatin e tejkalimit të dyfishit të pasurisë së ligjshme, si rezultat përfundimtar. Argumentet ligjore të përdorura nga Komisioni, në shpjegimin e mosjustifikimit të burimit të ligjshëm nga subjekti i rivlerësimit, për secilën pasuri, në vlerën e përcaktuar në vendim, krijojnë lidhjen logjike mes pjesës arsyetuese dhe urdhëruese, kur tejkalimi i dyfishit të pasurisë së ligjshme vjen si rezultat i krahasimit të vlerave të pasurisë së akumuluar në vite e deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën e pasurisë (*vetting*) 2017, me atë të vlerësuar nga Komisioni si pasuri e krijuar me burim të ligjshëm.

Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se pretendimi i subjektit të rivlerësimit është i pabazuar.

17. *Në lidhje me pretendimin në ankim se konkluzioni i nxjerrë nga Komisioni se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pamjaftueshëm për kontrollin e pasurisë është i gabuar, pasi subjekti ka kryer vetëm pasaktësi teknike dhe të paqëllimshme, pa dashje dhe se masa disiplinore e dhënë është joproporcionale, pasi trupi gjykues nuk ka vlerësuar raportet e institucioneve të inteligjencës dhe atyre të vlerësimit profesional të cilat duhet të jenë pozitive, për sa kohë nuk janë debatuar në seancë dëgjimore, trupi gjykues vlerëson se:*

Dispozitat kushtetuese dhe ligjore për procesin e rivlerësimit për kriterin e pasurisë, në asnjë rast nuk e lidhin pamjaftueshmërinë e deklaramit me elementet subjektive të dashjes apo qëllimit. Në këtë proces subjektit të rivlerësimit, bazuar në nenin D të Aneksit të Kushtetutës, i duhet të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave dhe nuk duhet të fshehë ose të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, posedim ose në përdorim të tij. Në shtojcën 2 të ligjit nr. 84/2016, në pjesën informuese të deklaramit të pasurisë për procesin e rivlerësimit, subjektet janë informuar mbi sanksionet në rast mosplotësimi me saktësi dhe vërtetësi të saj. Procesi i rivlerësimit është një procedurë administrative/sanksionuese (dhe asnjëherë një proces penal), i cili ofron të gjitha garancitë e një procesi të rregullt ligjor. Në lidhje me deklaramin e pasurisë, ligji nuk ka pasur në qëllim të tij përcaktimin e rrethanave lehtësuese apo rënduese, të lidhura me dashjen apo qëllimin, pasi në të kundërt do të kishte bërë përcaktime të tilla, si në nenin 38 për standardet e kontrollit të figurës.

Komisioni ka vepruar në përputhje me nenin 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016 i cili shprehet: “2. Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit. Vendimi merret bazuar në një ose disa prej kriterëve, në vlerësimin e përgjithshëm të tri kriterëve, ose në vlerësimin tërësor të procedurave.”

³ Vendimet nr. 38/2010; nr. 20/2012; nr. 28/2014 të Gjykatës Kushtetuese.

Në bazë të këtij parashikimi ligjor, Komisioni ka filluar hetimin administrativ për të tria kriteret e vlerësimit. Komisioni pasi ka vlerësuar se e ka hetuar në mënyrë të plotë kriterin e pasurisë, bazuar në vlerën provuese të provave të mbledhura, ka arritur në përfundimin se vlerësimi i subjektit të rivlerësimit, duhet të bëhet vetëm për kriterin e pasurisë. Komisioni, pasi ka arritur në përfundimin se provat kishin nivelin e provueshmërisë, i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës për të paraqitur prova ose shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën dhe subjekti i rivlerësimit është njohur me faktin se ai po vlerësohet vetëm për kriterin e pasurisë. Këtë pretendim subjekti i rivlerësimit nuk e ka ngritur gjatë zhvillimit procesit të rivlerësimit në Komision. Vlerësimi vetëm për njërin nga kriteret nuk prezumon se vlerësimi për dy kriteret e tjera është kryer dhe vendimi i Komisionit nuk e ka lënë këtë të nënkuptohet, në asnjë moment.

Dispozitat kushtetuese dhe ato ligjore parashikojnë vendosjen e masave disiplinore, në përfundim të vlerësimit edhe vetëm për një nga kriteret.

Sa më sipër, pretendimi i subjektit të rivlerësimit është i pabazuar.

18. Në lidhje me pretendimin se përfshirja në vendimin e Komisionit të qëndrimit emocional të subjektit të rivlerësimit në përfundim të seancës dëgjimore, si shkelje e etikës, faktin qëndrimin paragjykes të Komisionit, trupi gjykues vlerëson se:

Trupi gjykues i Komisionit, megjithëse ka përfshirë në vendim konstatimin e qëndrimit emocional të subjektit të rivlerësimit, nuk ka qenë paragjykes, pasi kjo ngjarje ka ndodhur, pasi gjykimi ishte mbyllur dhe ishte shpallur vendimi dhe, për pasojë, nuk ka pasur asnjë ndikim në vendimmarrje.

Për sa më sipër, pretendimi i subjektit të rivlerësimit është i pabazuar.

III. Analiza e shkaqeve të ankimit të lidhura me konstatimin e gjendjes faktike dhe zbatimin e ligjit material në lidhje me pasurinë dhe të ardhurat

19. Për pasurinë, sipas deklaratës së pasurisë (vetting) 2017:

Apartament banimi, me sipërfaqe 114,79 m², rruga {***}, Tiranë, prenotuar sipas aktmarrëveshjes datë 04.09.2009 me shoqërinë {***} SHPK, me vlerë 90.000 euro, me burim të deklaruar të të ardhurave:

Kursimet familjare ndër vite deri aktualisht; kontrata të shitjes së pasurisë së paluajtshme (tokë): nr. 5492 rep., nr. 2531/3 kol., datë 15.08.2008; nr. 5493 rep., nr. 2532/3 kol., datë 15.08.2008; nr. 546 rep., nr. 438/3 kol., datë 15.02.2010, si dhe kontratë kredie bankare nr. 6000 rep., nr. 975 kol., në vlerën 7,1 milionë lekë ose 50.000 euro.

20. Në lidhje me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se konstatimi i trupit gjykues të Komisionit në lidhje me mosdeklarimin në deklaratën e pasurisë 2017 të pronësisë së dy garazheve është i gabuar dhe paragjykes, pasi bashkëlidhur kësaj deklaratë, është depozituar pranë ILDKPKI-së, edhe aktmarrëveshja datë 04.12.2009 e lidhur me {***} SHPK, në të cilën parashikohet qartë dhe blerja e dy garazheve në çmimin total të deklaruar prej 90.000 eurosh, duke përmbushur kështu detyrimin për të deklaruar pasuritë në pronësi, trupi gjykues konstaton se:

21. Subjekti i rivlerësimit, për pasurinë e sipërcituar, bashkëlidhur deklaratës së pasurisë (vetting) 2017, ka dorëzuar dokumentin justifikues aktmarrëveshje, të lidhur në datë 04.12.2009, ndërmjet shoqërisë {***} SHPK dhe A.N. (bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit), në të cilin palët bien dakord të lidhin ndërmjet tyre kontratë sipërmarrjeje. Në këtë aktmarrëveshje rezulton se palët kanë rënë dakord që në kontratën e sipërmarrjes do të deklarohet vlera: 80.000 euro për apartamentin dhe 10.000 euro për dy poste parkimi.

Në deklaratën periodike të pasurisë 2009, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar vetëm apartamentin dhe jo postet e parkimit, ndërsa në vitin 2010 ka deklaruar apartamentin dhe 2 poste parkimi për shumën totale 90.000 euro. Sipas të dhënave të shkresës nr. 44867/1 prot., datë 11.01.2018 të Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Tiranë, garazhi me sipërfaqe 21,1 m² dhe garazhi me sipërfaqe 19,20 m² janë të regjistruar si pasuri më vete në emër të Besa Rexhep Nikëhasani dhe A.N.N. Deklarata e pasurisë (*vetting*) 2017 kërkon përshkrimin me hollësi të të gjitha pasurive të akumuluar, ndër vite deri në ditën e dorëzimit të kësaj deklaratë.

Për pasojë, trupi gjykues vlerëson se është i drejtë vendimi i Komisionit se subjekti i rivlerësimit nuk ka qenë i saktë në deklarimin e tij, në lidhje me pronësinë e dy garazheve me sipërfaqe 21,1 m² dhe 19,20 m².

22. Lidhur me pretendimin në ankim se është i gabuar konkluzioni i Komisionit se subjekti i rivlerësimit ka përdorur deklaratë të rreme për të justifikuar me burim të ligjshëm të ardhurash pasurinë e blerë, apartament, sip. 144,79 m², me adresë rr. {***}, Tiranë, pasi deklarata noteriale e shtetases M.N.nr. 3648 rep., nr. 2276 kol., datë 22.08.2013, për dhurimin e shumës 752.880 lekë djalit të saj A.N., është në përputhje me dy kontratat e shitblerjes së vitit 2008 dhe këto të ardhura janë përfituar në vitin 2008, ndërsa në lidhje me sa shprehet deklarata noteriale për kohën e dhurimit të parave, ka një lapsus të bërë nga noteri publik, trupi gjykues konstaton se:

23. Në deklaratën e pasurisë (*vetting*) 2017, subjekti i rivlerësimit deklaroi si burim krijimi për pasurinë e sipërcituar, ndër të tjera edhe:

- kontratë shitblerjeje e pasurisë së paluajtshme (tokë arë) nr. 5492 rep., nr. 2531/3 kol., datë 15.08.2008, me palë: shitës M.N. dhe blerës Gj. H., për sipërfaqen 1530 m², me çmim shitjeje 376400 lekë;

- kontratë shitblerjeje e pasurisë së paluajtshme (tokë arë) nr. 5493 rep., nr. 2532/3 kol., datë 15.08.2008, me palë: shitës M.N. dhe blerës L. H., për sipërfaqen 1530 m², me çmim shitjeje 376400 lekë.

Përveç kontratave të sipërcituara, subjekti i ka bashkëlidhur deklaratën e pasurisë (*vetting*) 2017, si dokumentacion justifikues edhe deklaratën noteriale të shtetases M.N. nr. 3648 rep., nr. 2276 kol., datë 22.08.2013, si dhe Akt i Marrjes së Tokës në Pronësi, me nr. regjistrimi 8636.

Nga aktet e administruara si provë, rezulton se si palë shitëse në këto kontrata është Mare Nikëhasani, vjehrra e subjektit. Përfituesi i të ardhurave të krijuara nga shitja e pasurisë së paluajtshme, sipas këtyre kontratave është Mare Nikëhasani. Bashkëlidhur secilës prej këtyre kontratave gjenden edhe certifikatat e vërtetimit të pronësisë mbi tokën arë të palës shitëse Mare Nikëhasani, harta treguese e regjistrimit dhe kartela e pasurisë së paluajtshme, të lëshuara nga Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Lezhë si dhe certifikata familjare e shitëses, e lëshuar nga zyra e gjendjes civile Lezhë, Komuna Shën Koll, në të cilën ajo figuron si anëtare e vetme e familjes bujqësore. Akti i Marrjes së Tokës në Pronësi, me nr. regjistrimi 8636, datë s'ka, Rrethi Lezhë, Fshati Rrilë, në mbështetje të ligjit "Për tokën" nr. 7501, datë 19.07.1991, i jep në pronësi familjes së Mare Nikëhasani, nga fshati Rrilë 19000 m² si vijon: 19000 m² arë dhe 80 m² truall.

Dokumentacioni i analizuar më sipër, në kuptim të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016 shërben për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurisë, për personin tjetër të lidhur Mare Nikëhasani, të ardhurat e tjetërsimit të së cilës, me deklaratën noteriale nr. 3648 rep., nr. 2276 kol., datë 22.08.2013, ajo ia dhuron djalit të saj A.N..

Nga deklarata e pasurisë (*vetting*) 2017, si dhe nga deklarata periodike e pasurisë 2008 rezulton se subjekti i rivlerësimit e deklaroi pronën në emër të personit tjetër të lidhur M. N., deklaroi shitjen

e pronës nga personi tjetër i lidhur, por nuk ka paraqitur asnjë akt provues për kalimin e shumave, që të justifikojë përfitimin e të ardhurave nga tjetërsimi i këtyre pronave. Dokumenti i vetëm justifikues i paraqitur është deklarata noteriale e sipërpërmendur.

Nga deklarata noteriale nr. 3648 rep., nr. 2276 kol., datë 22.08.2013, rezulton se veprimi juridik i dhurimit ka ndodhur më datë 22.08.2013, duke mos qenë në përputhje me deklarimin e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë (*vetting*) 2017 dhe deklaratën periodike të pasurisë 2008, se të ardhurat e rrjedhura nga shitja e tokës bujqësore i ka përfituar në vitin 2008. Subjekti i rivlerësimit pretendon se kjo mospërputhje vjen si rezultat i një lapsusi të bërë nga noteri publik, i cili ka redaktuar deklaratën noteriale.

24. Në vërtetimin e tij, datë 27.03.2018, noteri V. M., shprehet se: “[...] në deklaratën noteriale me nr. 3648 rep., nr. 2276 kol., datë 22.08.2013, të nënshkruar nga Mare Nikëhasani, deklarimi se shuma prej 752800 lekë, është marrë sot më datë 22.08.2013 është i gabuar me COPY PASTE i Deklaratës për D.N. (është lapsus në shkrim i imi). [...] E lëshoj këtë vërtetim me kërkesën e të interesuarit, për t’u paraqitur ku të jetë e nevojshme.”

Noteri V. M. në këtë vërtetim, për sa rezulton nga përmbajtja, nëpërmjet sqarimit të gabimit të kryer prej tij, ka vërtetuar një fakt krejt të ndryshëm nga ai që ka deklaruar shtetasja M.N.me vullnetin e saj, në deklaratën noteriale të vitit 2013. Në vitin 2018, noteri deklaroi kohën kur është arkëtuar shuma nga shitja e pronës, kohën kur është bërë dhënia e kësaj shume nga njëra prej palëve kontraktuese të një palë e tretë dhe arsyeën pse është bërë dhënia e kësaj shume të pala e tretë, duke ndryshuar kështu tërësisht vullnetin e shtetasës M.N., të shprehur në deklaratën e datës 22.08.2013 dhe duke i dhënë vërtetimit të tij përmbajtjen e një deklarate të re, me deklarues vetë noterin. Noteri vërteton kështu fakte pa praninë e deklarueses, në sqarim të gabimit të tij *copy paste* në aktin noterial, krejt të ndryshme nga ato që ka shprehur deklaruesja me vullnetin e saj të lirë, në deklaratën në të cilën është bërë gabimi i pretenduar.

Nisur nga sa më sipër, rezulton se vërtetimi datë 27.03.2018 i noterit V. M. është në tejkalim të kompetencave të tij të përcaktuara në nenin 39 të ligjit nr. 7829, datë 1.09.1994, “Për noterinë”, i ndryshuar. Ligji për noterinë i sipërcituar, në nenin 50 të tij përcakton se korrigjimet në aktin noterial mund të bëhen vetëm gjatë redaktimit të tij dhe përbri tyre nënshkruajnë palët dhe noteri. Në këtë rast, noteri konstaton një gabim në deklaratën noteriale, jo gjatë redaktimit, por rreth pesë vite më vonë, pa praninë e palës deklaruese të vullnetit. Në deklaratën noteriale nr. 3648 rep., nr. 2276 kol., datë 22.08.2013, në paragrafin e fundit noteri shprehet: “Ky akt, pasi u lexua me zë të lartë dhe u gjet konform kërimit dhe vullnetit të lirë dhe të plotë të deklaruesja, u nënshkrua prej saj rregullisht dhe unë duke e gjetur të bazuar në ligj e vërtetoj”. Pra, noteri kryesisht, por edhe deklaruesja kishin të gjitha mundësitë të konstatojnë gabimin në redaktim, që në kohën e redaktimit të aktit, por përkundrazi e kanë gjetur atë konform kërimit dhe vullnetit të deklarueses. **Për sa më sipër, trupi gjykues e gjen të drejtë vendimin e Komisionit se subjekti i rivlerësimit ka përdorur deklaratë të rreme në lidhje me përfitimin e të ardhurave nga kontratat e shitjes së pasurisë të paluajtshme, nga personi tjetër i lidhur në vitin 2008, për të justifikuar me burim të ligjshëm të ardhurash pasurinë e blerë apartament, sipërfaqja 144,79 m², rruga {***}, Tiranë.**

25. *Lidhur me pretendimin në ankim se qëndrimi i Komisionit është paragjyqës, pasi nuk qëndron arsytimi i tij ligjor se nëse subjekti do të donte të provonte dhurimin e shumës, të përfituar nga shitja e tokës nga ana e vjehrrës me kontratat e vitit 2008, do të duhej të përfshinte edhe të ardhurat*

e përfituara nga shitja e një cope toke tjetër me kontratën e shitblerjes së pasurisë së paluajtshme në vitin 2010, për shumën 502.000 lekë, trupi gjykues konstaton se:

26. Në deklaratën e pasurisë (*vetting*) 2017, kontrata e shitblerjes së pasurisë së paluajtshme (tokë arë) nr. 546 rep., nr. 438/3 kol., datë 15.02.2010, me palë: shitës M.N. dhe blerës Gj. P., për sipërfaqen 2040 m², me çmim shitjeje 502.000 lekë, është përdorur si burim krijimi për pasurinë apartament banimi, me sipërfaqe 144,79 m², rruga {***}, Tiranë.

Në deklaratën periodike të pasurisë 2010, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar shitjen e sip. 2040 m² (tokë arë në fshatin Rrilë, Lezhë, në emër të vjehrrës) sipas kontratës nr. 546 rep., nr. 438/3 kol., në vlerën 500.000 lekë, datë 15.02.2010.

Sipas deklaratës periodike të pasurisë 2008, sipërfaqja e tokës së mbetur në emër të vjehrrës është 1500 m², jo 2040 m² sa disponohet sipas kontratës së sipërpërmendur.

Në dokumentacionin shoqërues të deklaratës së pasurisë (*vetting*) 2017, subjekti i rivlerësimit nuk paraqet asnjë dokument justifikues për kalimin e shumës 502.000 lekë të përfituar nga shitja e tokës, nga M.N. te subjekti i rivlerësimit apo bashkëshorti i saj. Subjekti i rivlerësimit pretendon se këto të ardhura i ka marrë, pasi vjehrra jetonte me ta. Vjehrra e subjektit të rivlerësimit nuk figuron në asnjë moment në përbërjen familjare të subjektit, bazuar në certifikatat familjare. Por, edhe nëse pranohet se faktikisht M. N. ka jetuar me familjen e subjektit të rivlerësimit në periudhën e pretenduar, ajo gëzon të gjithë të drejtën të disponojë lirshëm të ardhurat e përfituara nga shitja e pronës në emër të saj dhe të disponojë lirisht me dhurim, mbi të. Bazuar në nenin D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës i lind detyrimi subjektit të rivlerësimit të vërtetojë bindshëm, se i ka përfituar këto të ardhura në format e njohura nga legjislacioni në fuqi. Subjekti i rivlerësimit pretendon se në vitin 2013 i është nënshtruar kontrollit të plotë të pasurisë nga ILDKPKI-ja dhe në atë rast i është kërkuar një deklaratë noteriale për vërtetimin e dhurimit të të ardhurave të kontratave të shitjes së tokës arë, nga vjehrra e saj. Në rast se do t'i kërkohej nga ILDKPKI-ja, një deklaratë noteriale edhe për përfitimin e të ardhurave nga kontrata e vitit 2010, atëherë ajo do të kishte paraqitur edhe një deklaratë të tillë.

27. Trupi gjykues arsyeton se ligji nr. 9049, datë 10.04.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, duke pasur në frymën dhe qëllimin e tij deklarimin e pasurive dhe burimin e krijimit të tyre në momentin e krijimit të tyre, në nenin 4 të tij (përcaktim i pandryshuar që nga hyrja e ligjit në fuqi) përcakton se subjektet deklaruese detyrohen të deklarojnë brenda datës 31 mars të çdo viti, gjendjen deri më 31 dhjetor të vitit paraardhës të pasurive, burimet e krijimit të tyre, si dhe të detyrimeve financiare.

Sa më sipër, detyrimi për subjektin e deklarimit për të deklaruar burimin e krijimit të pasurisë, lind që në momentin e deklarimit vjetor të pasurisë, pra që në momentin e krijimit të kësaj pasurie, që do të thotë se në rastin konkret, subjektit të rivlerësimit, detyrimi për të provuar përfitimin e të ardhurave nga kontrata e shitjes së tokës bujqësore nga personi tjetër i lidhur me të, M. N., i ka lindur që në vitin 2010.

Këtë detyrim subjekti i rivlerësimit e ka pasur gjatë plotësimit të deklaratës së pasurisë (*vetting*) 2017, në zbatim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, ligjit nr. 86/2014, të cilët urdhërojnë shpjegimin bindshëm - me dokumentacion justifikues (shkresor) të burimit të krijimit të pasurisë

për subjektet e rivlerësimit, por edhe udhëzimit nr. 4095 prot., datë 10.10.2016, të Inspektorit të Përgjithshëm të ILDKPKI-së⁴, i cili në pikën 7 udhëzon se për çdo pasuri në pronësi, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të, duhet të deklarojë burimin, në momentin e krijimit për secilën prej tyre, duke bashkëlidhur dokumentacionin ligjor për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit për secilën pasuri, në momentin e fitimit të tyre. Në pikën 12 i njëjti udhëzim shprehet se deklarimi i pasurive të paluajtshme, të luajtshme, likuiditeteve dhe çdo pasurie tjetër të fituar nëpërmjet dhurimit, të shoqërohet me dokumentacionin justifikues ligjor për këtë veprim juridik, si dhe dokumentacionin justifikues të pronësisë të personit tjetër të lidhur (dhuruesit).

Subjekti i rivlerësimit, megjithëse subjekt deklarimi në bazë të ligjit nr. 9049/2003, që në vitin 2003, në përmbushje të detyrimit kushtetues dhe ligjor, ka mungesë të dokumentacionit justifikues ligjor, që të vërtetojë bindshëm përfitimin e të ardhurave nga kontrata e shitjes së pasurisë së paluajtshme (tokë arë) nr. 546 rep., nr. 438/3 kol., datë 15.02.2010, me palë: shitës M.N.dhe blerës Gj. P., për sipërfaqen 2040 m², me çmim shitjeje 502.000 lekë.

Në lidhje me kontratat e shitjes së pasurisë së paluajtshme të vitit 2008⁵, trupi gjykues vlerëson se megjithëse subjekti i rivlerësimit është përpjekur t'i justifikojë ato me deklaratë noteriale të personit tjetër të lidhur M. N.⁶, edhe nëse kjo deklaratë do të kishte përmbajtjen e pretenduar nga subjekti i rivlerësimit, përsëri nuk do të kishte vlerë provuese, pasi nuk është bërë në momentin e krijimit të të ardhurave dhe nuk ka asnjë dokumentacion provues për kalimin e këtyre të ardhurave nga personi tjetër i lidhur te subjekti i rivlerësimit.

Në përfundim të këtij arsyetimi, trupi gjykues çmon se në lidhje me të ardhurat e deklaruara nga shitja e tokës bujqësore në emër të vjehrrës, sipas kontratave të shitjes së pasurisë së paluajtshme (tokë): nr. 5492 rep., nr. 2531/3 kol., datë 15.8.2008; nr. 5493 rep., nr. 2532/3 kol., datë 15.8.2008; nr. 546 rep., nr. 438/3 kol., datë 15.02.2010, subjekti nuk vërteton me asnjë dokument përfitimin e tyre, duke kryer për pasojë deklaram të rremë. Për sa më sipër, pretendimet e tij për të kundërtën, janë të pabazuara.

28. *Lidhur me pretendimin se është i gabuar konkluzioni i Komisionit se subjekti nuk justifikon me të ardhura të ligjshme diferencat e shumave të deklaruara si kursime për periudhën 2007-2011, pasi mënyra e përlllogaritjes së Komisionit përbën një gabim material, në paraqitjen e një bilanci, ku mungon analiza e të ardhurave dhe e shpenzimeve të subjektit deklarues dhe se qëndrimi i Komisionit në lidhje me shpenzimet e jetesës së subjektit të rivlerësimit është paragjykes pasi nuk mundet që “dyshimet e arsyeshme”, të pabazuara në asnjë provë apo indicie të bëhen bazë e vendimit, trupi gjykues konstaton se:*

Siç rezulton nga deklaramet vjetore të pasurisë, për periudhën 2009-2010, subjekti i rivlerësimit, nga kursimet familjare, i ka paguar {***} SHPK, sipas kontratës së sipërmarrjes për apartamentin në rrugën {***}, Tiranë shumë:

⁴ Udhëzimi nr. 4095 prot., datë 10.10.2016 i Inspektorit të Përgjithshëm të ILDKPKI-së “Për mënyrën e deklarimit të pasurive, në pronësi, posedim dhe përdorim, burimet e krijimit të tyre, detyrimet financiare etj., nga subjektet e rivlerësimit dhe personat e lidhur që mbartin detyrim për deklarim të pasurisë, në zbatim të ligjit nr. 84/2016, datë 30.08.2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

⁵ Kontratë shitblerjeje e pasurisë së paluajtshme (tokë arë) nr. 5492 rep., nr. 2531/3 kol., datë 15.08.2008, me palë: shitës M.N.dhe blerës Gj. H., për sipërfaqen 1530 m², me çmim shitjeje 376.400 lekë; kontratë shitblerjeje e pasurisë së paluajtshme (tokë arë) nr. 5493 rep., nr. 2532/3 kol., datë 15.08.2008, me palë: shitës M.N.dhe blerës L. H., për sipërfaqen 1530 m², me çmim shitjeje 376.400 lekë.

⁶ Deklarata nr. 3648 rep., nr. 2276 kol., datë 22.08.2013.

Në vitin 2009: 10.000 euro e konvertuar në lekë (1 euro: 137,17 lekë, sipas kursit të këmbimit të monedhës euro në 31.12.2009⁷) në vlerën 1.371.700 lekë.

Në vitin 2010: 20.000 euro e konvertuar në lekë (1 euro: 138,81 lekë, sipas kursit të këmbimit të monedhës euro në 31.12.2010,) në vlerën 2.776.200 lekë.

Në vitin 2011: 10.000 euro e konvertuar në lekë (1 euro: 138,30 lekë, sipas kursit të këmbimit të monedhës euro në 31.12.2011,) në vlerën 1.383.000 lekë.

Në total, në periudhën 2009-2011, subjekti i rivlerësimit ka paguar *cash* nga kursimet familjare kundrejt {***} SHPK, shumën 5.530.900 lekë.

Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar ndër vite kursimet si më poshtë:

Nga viti 2003-2006, ka deklaruar në çdo vit 0 lekë kursime.

Në vitin 2007 ka deklaruar 300.000 lekë.

Në vitin 2008 ka deklaruar 1.700.000 lekë.

Në vitin 2009 ka deklaruar 1.300.000 lekë.

Në vitin 2010 ka deklaruar 1.400.000 lekë dhe 2000 euro (1 euro: 138,81 lekë, sipas kursit të këmbimit të monedhës euro në 31.12.2010) në total për këtë vit 1.677.620 lekë.

Në vitin 2011 ka deklaruar 1.250.000 lekë dhe 1000 euro (1 euro: 138,30 lekë, sipas kursit të këmbimit të monedhës euro në 31.12.2011) në total për këtë vit 1.388.300 lekë.

Në total në periudhën 2007-2011, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar kursimet familjare në shumën 6.365.920 lekë.

29. Bazuar në të ardhurat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit në deklaratimet vjetore të pasurisë për periudhën 2007-2011, duke zbritur shpenzimet e jetesës të përlllogaritura sipas të dhënave zyrtare publikuar nga INSTAT për këtë periudhë, kursimet faktike për secilin vit rezultojnë të jenë respektivisht:

Për vitin 2007 në shumën 149.568 lekë.

Për vitin 2008 në shumën 2.068.880 lekë.

Për vitin 2009 në shumën 132.182 lekë.

Për vitin 2010 në shumën -650.918 lekë.

Për vitin 2011 në shumën -83.141 lekë.

Nga krahasimi i kursimeve të përlllogaritura si më sipër me ato të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit në deklaratimet vjetore të pasurisë, rezulton të ketë diferenca të pajustificuara në shumat si vijon:

Për vitin 2007 ka deklaruar më shumë se sa mund të kursente në shumën 150.432 lekë.

Për vitin 2008 ka deklaruar më pak se sa mund të kursente në shumën 368.380 lekë.

Për vitin 2009 ka deklaruar më shumë se sa mund të kursente në shumën 1.167.818 lekë.

Për vitin 2010 ka deklaruar më shumë se sa mund të kursente në shumën 2.328.538.

Për vitin 2011 ka deklaruar më shumë se sa mund të kursente në shumën 1.471.441 lekë.

Në total, diferencë e pajustificuar për gjithë periudhën 2007-2011, është shuma 4.749.349 lekë.

Pra, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në periudhën 2007-2011 më shumë se sa mund të kursente.

Bazuar në sa më sipër, trupi gjykues çmon se subjekti i rivlerësimit nuk justifikon me të ardhura të ligjshme diferencat e shumave të deklaruara si kursime për periudhën 2007-2011, në shumën 4.749.349 lekë. Për sa më sipër, pretendimet e tij janë të pabazuara.

⁷ Kursi i këmbimit 31 dhjetor, duke qenë se kursimet deklarohen duke reflektuar gjendjen e fundvitit.

30. Në këto kushte, trupi gjykues, pasi analizoi faktet dhe vlerësoi të gjitha provat në lidhje me pasurinë apartament me sipërfaqe 144,79 m² dhe dy garazhe me sipërfaqe 21,1 m² dhe 19,2 m², në rrugën {***}, Tiranë, arrin në përfundimin se vendimi i Komisionit është i drejtë pasi subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar blerjen e kësaj pasurie dhe ka kryer deklarim të rremë për të ardhurat, me qëllim justifikimin e kësaj pasurie me burime të ligjshme.

31. Për pasuritë sipas deklaratës së pasurisë (*vetting*) 2017:

i. Shtëpi banimi me sipërfaqe 76 m², {***}, Lezhë, prenotuar sipas kontratës së porosisë nr. 1540 rep., nr. 211 kol., datë 15.05.2010, me vlerë 28.000 euro, me burim të deklaruar krijimi:

a) 25.000 euro, marrë nga shoqëria {***} SHPK, me mandat pagese nr. 20, datë 14.05.2010, sipas aktmarrëveshjes nr. 860 rep., nr. 652 kol., datë 17.03.2011, për prishjen e pallatit në Lezhë, ku kemi pasur në pronësi një apartament me sipërfaqe 130 m², i blerë në vitin 1998, me vlerë 1.500.000 lekë, i papërfunduar, me burim të ardhurat nga shitja e shtëpisë sonë dhe 1.380 m² tokë në fshatin Rrilë, Lezhë, po në vitin 1998, me vlerë 1.500.000 lekë, sipas kontratës nr. 2078 rep., datë 16.09.1998;

b) 3.000 euro kursime nga të ardhurat familjare të vitit 2009.

ii. Njësi shërbimi, plus sipërfaqet e përbashkëta 150 m², në unazën e qytetit Lezhë, {***}, përfituar sipas aktmarrëveshjes me shoqërinë {***} SHPK, nr. 860 rep., nr. 652 kol., datë 17.03.2011, për prishjen e pallatit Lezhë.

Këto dy pasuri janë trajtuar së bashku, pasi subjekti i rivlerësimit deklaroi të njëjtin burim krijimi për to: aktmarrëveshjen nr. 860 rep., nr. 652 kol., datë 17.03.2011, për prishjen e pallatit në Lezhë.

32. Në lidhje me pretendimin në ankim se është i gabuar konkluzioni i Komisionit se subjekti i rivlerësimit përdor çdo kontratë shitjeje të kryer nga personat e tjerë të lidhur si burim të ardhurash, pasi në deklaratimet periodike vjetore janë përdorur vetëm kontratat e shitjes të kryera nga nëna e bashkëshortit (për pjesën takuese të bashkëshortit dhe të nënës së tij), që ka jetuar së bashku me familjen e subjektit të rivlerësimit deri në vitin 2011, trupi gjykues konstaton se:

Në deklaratimet periodike të pasurisë në vite, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në lidhje me tokën bujqësore apo shitblerjen e saj, në vitet 2004, 2008 dhe 2010. Sipas deklaratës së vitit 2004, me të ardhurat e përfituara nga tri kontrata shitjeje të tokës bujqësore, në emër të vjehrrës përfituar nga ligji nr. 7501 “Për tokën”, ka kryer punime në shumën 2.100.000 lekë në apartament banimi në rrugën {***}, Lezhë. Në deklaratën e vitit 2008 deklaroi 750.000 lekë të ardhura nga shitja e 3000 m² tokë bujqësore përfituar nga ligji nr. 7501, në emër të nënës së bashkëshortit, ndërsa në vitin 2010 deklaroi shitje tokë arë, në emër të vjehrrës, sipas kontratës nr. 546 rep., nr. 438/3 kol., datë 15.02.2010, sipërfaqe 2040 m², në vlerën 500.000 lekë.

Në deklaratën e pasurisë (*vetting*) 2017 deklaroi si burim krijimi për blerjen e apartamentit në rrugën {***}, Tiranë, të ardhurat nga kontrata të shitjes së pasurisë së paluajtshme (tokë): nr. 5492 rep., nr. 2531/3 kol., datë 15.08.2008; nr. 5493 rep., nr. 2532/3 kol., datë 15.8.2008; nr. 546 rep., nr. 438/3 kol., datë 15.02.2010.

Në këto deklarime, subjekti i rivlerësimit nuk jep asnjë shpjegim në lidhje me të drejtat e tij mbi pasurinë tokë bujqësore dhe nuk deklaroi saktë, në lidhje me të drejtat mbi këtë pasuri të personit tjetër të lidhur – nënës së bashkëshortit.

Rezulton se, bazuar në ligjin nr. 7501, datë 19.07.1991 “Për tokën”, i ndryshuar, dhe Vendimit të

Këshillit të Ministrave nr. 255, datë 2.08.1991, “Për kriteret e ndarjes së tokës bujqësore”⁸, familja e Mare Nikëhasanit ka përfituar sipas Aktit të Marrjes së Tokës në Pronësi (AMTP) nr. regjistrimi 8636, datë s’ka, rrethi Lezhë, fshati Rrilë, 19.000 m² si vijon: 19.000 m² arë dhe 80 m² truall. Bazuar në certifikatën familjare nr. {***}, të datës 06.02.2018, të dorëzuar nga subjekti i rivlerësimit⁹, rezulton se në bazë të regjistrimit themeltar të vitit 1974, Rrilë, fleta 117, gjendja familjare në datën 01.08.1991 e M.N. është: M. N. kryefamiljare, P. N., D. N., A. N., të cilët janë bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit dhe vëllezërit e tij. Sipas kreut II, ndarja B e Kodit Civil, pronësia mbi pasurinë e anëtarëve të familjes bujqësore u përket në tërësi anëtarëve të saj dhe ajo përfaqësohet në marrëdhëniet pasurore me të tretët nga kryetari. Sipas nenit 228 të këtij Kodi, pjesëtimi i pasurisë së familjes bujqësore, bëhet sipas rregullave të përcaktuara nga neni 207 i tij¹⁰.

33. Subjekti i rivlerësimit, në ankim pretendon se ka përfituar të ardhurat nga shitja e pjesës takuese të vjehrrës dhe pjesës takuese të bashkëshortit të saj, duke e pjesëtuar idealisht në 4 pasurinë tokë bujqësore me sipërfaqe 19.000 m² + 80 m² truall, me pjesë 4750 m² secila¹¹, por nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion që të provojë ndarjen bashkëpronësisë në tërësi-tokës bujqësore mes anëtarëve të familjes, pasi siç edhe vetë deklaroi nuk ka bërë pjesëtim pasurie as me kunetërit, as me vjehrrën.

Subjekti i rivlerësimit pretendon se për llogari të familjes së saj (dy prej bashkëpronarëve: nëna M. N. dhe bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit A. N.) janë shitur 10.125 m² tokë, ndërsa për llogari të dy bashkëpronarëve të tjerë (P. N. dhe D. N. - vëllezërit e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit) janë shitur: 7.381 m² tokë.

Rezulton se sipërfaqja e pretenduar, e shitur për llogari të familjes së saj është më e madhe se pjesët ideale të bashkëshortit të saj dhe nënës së tij së bashku, duke prekur apo cënuar pjesët e bashkëpronarëve të tjerë.

34. Subjekti i rivlerësimit pranon se në deklarin periodik të pasurisë në vitin 2004 ka kryer pasaktësi, pasi të ardhurat e përfituara nga kontrata nr. 316 rep., nr. 129 kol., datë 25.02.2004, kanë shkuar në favor të vëllait të bashkëshortit P. N., duke pranuar si kontrata nga të ardhurat e të cilave ka përfituar deri në vitin 2004 vetëm ato me nr. 1754 rep., nr. 612 kol., datë 07.02.2002 në sipërfaqen 1.675 m², në vlerën 1.100.000 lekë dhe nr. 1669 rep., nr. 558 kol., datë 08.09.2003, në sipërfaqen 3350 m², në vlerën 1.000.000 lekë.

Subjekti i rivlerësimit pretendon se është shitur gjithë sipërfaqja e tokës në pronësi të M. N., përfshirë edhe sipërfaqja prej 3.009 m² tokë, por ende nuk është formalizuar me kontratë veprimi i shitjes. Sipas shkresës me nr. 10100/1 prot., datë 17.01.2018 të Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Lezhë, rezulton se M.N. ka në pronësi 3.009 m² tokë arë.

Sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se duke qenë përpara faktit se bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit është një nga bashkëpronarët në tërësi të tokës bujqësore, në mungesë të dokumentacionit vërtetues për mënyrën se si bashkëpronarët i kanë ndarë të ardhurat e tjetërsimit të sendit të përbashkët, është i drejtë konkluzioni i Komisionit se subjekti i

⁸ Pika 2 e këtij vendimi përcakton: “Në të gjitha rastet toka ndahet përpjesëtimisht për çdo familje sipas numrit të frymëve të gjendjes civile në datën 1 gusht 1991”

⁹ Certifikata familjare gjendje 01.08.1991, bashkëlidhur vërtetimit nr. 362 prot., datë 07.02.2018, Njësia Administrative ShënKoll, i cili përmban edhe fotokopje të AMTP në përgjigjet e kërkesës për deklarin të Komisionit, datë 8.02.2018 (fashikulli nr. 6, f. 657-659).

¹⁰ Neni 207, paragrafi i parë i Kodit Civil: “Pjesëtimi i sendit të përbashkët kryhet me marrëveshjen e të gjithë bashkëpronarëve. Kur sendi është i paluajtshëm marrëveshja duhet të bëhet me akt noterial. Kur kjo marrëveshje nuk është arritur, pjesëtimi i sendit kryhet me anë të gjykatës, duke thirrur në gjyq të gjithë bashkëpronarët. Pjesëtimi i sendit të përbashkët bëhet me ndarjen e tij në natyrë sipas pjesëve që kanë bashkëpronarët, në qoftë se kjo ndarje është e mundshme dhe nuk dëmton qëllimin përkatës të sendit. Pabarazia e pjesëve, që rezulton nga ndarja në natyrë kompensohet me një shpërblim në para”.

¹¹ Subjekti i rivlerësimit nuk paraqet qëndrueshmëri për këtë deklarin, pasi herë e llogarit 4500 m² dhe herë 4750 m².

rivlerësimit përdor si burim të ardhurash çdo kontratë shitjeje të kryer nga personat e tjerë të lidhur.

35. *Lidhur me pretendimin në ankim se qëndrimi i Komisionit, i cili nuk ka marrë në konsideratë deklaratën noteriale të deklaruesve M. N., P. N. dhe F. Sh., të cilët legjitimojnë veprimet e kryera në vitin 2002 e 2003, se i kanë dhuruar bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit shumën 2.100.000 lekë është paragjykes, trupi gjykues konstaton se:*

Në deklaratën e pasurisë (*vetting*) 2017, subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar të ardhurat e përfituara nga kontratat e shitjes së tokës bujqësore nr. 1754 rep., nr. 612 kol., datë 07.02.2002 për sipërfaqen 1.675 m², në vlerën 1.100.000 lekë dhe nr. 1669 rep., nr. 558 kol., datë 08.09.2003, për sipërfaqen 3.350 m², në vlerën 1.000.000 lekë, ku palë shitëse kanë qenë M. N., P. N. dhe F. N., të cilat i ka përdorur për të kryer punime në apartamentin në rrugën {***}, Lezhë. Subjekti i rivlerësimit për të vërtetuar se të ardhurat e përfituara nga këto kontrata kanë shkuar për llogari të familjes së saj, ka paraqitur deklaratë noteriale nr. 115 rep., nr. 53 kol., datë 17.02.2018 të shtetasve M.N., P.N. dhe F.N..

Kjo deklaratë noteriale është redaktuar nga noteri publik K. L., me seli në Laç, i cili duke vepruar në kundërshtim me nenin 16¹² të ligjit nr. 7829, datë 1.09.1994, “Për noterinë”, i ndryshuar, ka redaktuar një akt në Montecatini Terme, Pistoia, Itali, jashtë territorit të përcaktuar për ushtrimin e veprimtarisë së tij. Akti është redaktuar në datë 20.02.2018, vetëm dy ditë përpara se subjekti i rivlerësimit t’i kthente përgjigje kërkesës për deklarim të Komisionit.

36. Trupi gjykues çmon se kjo deklaratë noteriale, megjithëse nuk është e pavlefshme, në kuptim të legjislacionit për noterinë, ajo nuk ka fuqi provuese në kuptim të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 86/2014, të cilët kërkojnë dokumentacionin provues për burimin e krijimit të pasurisë, në momentin e krijimit të kësaj pasurie.

Sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se është i drejtë vendimi i Komisionit se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarim të rremë në lidhje me burimin e ligjshëm të të ardhurave në shumën 2.100.000 lekë, si dhe fshehje të kësaj shume në deklaratën e pasurisë (*vetting*) 2017.

37. *Lidhur me pretendimin në ankim se është i gabuar konkluzioni i Komisionit se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti i saj janë sjellë si pronarë të ligjshëm të apartamentit të prishur në rrugën {***}, Lezhë duke lidhur aktmarrëveshje dhe kontratë shkëmbimi për të, edhe pse nuk kanë pasur pronësinë ligjore të vërtetuar me dokument zyrtar, pasi në shkëmbimin e kësaj pasurie palët janë bazuar në legjislacionin në fuqi në momentin e kryerjes së veprimit juridik, në nenin 83 e vijues të Kodit Civil si dhe në nenin 757 të tij, trupi gjykues konstaton se:*

Subjekti i rivlerësimit, apartamentin në rrugën {***}, Lezhë e ka deklaruar për herë të parë në deklaratën periodike të pasurisë 2004, si “shtëpi banimi me sipërfaqe 90 m², blerë në vitin 2001

¹² Neni 16, paragrafi i tretë i ligjit nr. 7829, datë 1.9.1994 “Për noterinë”, i ndryshuar: Noteri nuk mund të ushtrojë veprimtarinë e tij jashtë territorit të njësisë vendore të caktuara në urdhrin e Ministrisë së Drejtësisë, me përjashtim të rasteve të veçanta kur një gjë e tillë miratohet, për një periudhë kohore jo më shumë se 60 ditë, nga të dy dhomat përkatëse të noterisë. Kryerja nga noteri e akteve dhe e veprimeve noteriale jashtë territorit të përcaktuar për ushtrimin e veprimtarisë së tij nuk sjell pavlefshmërinë tyre.

karabina, me burim krijimi kursimet në vite dhe ndihma e vëllezërve të bashkëshortit në emigracion, vlera e përfunduar e shtëpisë 3.700.000 lekë”.

Në deklaratën e pasurisë (*vetting*) 2017, këtë apartament e deklaroi si burim krijimi për dy pasuritë: shtëpi banimi me sipërfaqe 76 m², Shëngjin, Lezhë dhe njësi shërbimi, plus sipërfaqet e përbashkëta 150 m² rr. {***}, Lezhë. Në këtë deklaratë apartamenti në rrugën {***}, Lezhë, deklarohet me sipërfaqe 130 m², i blerë në vitin 1998, me vlerë 1.500.000 lekë, i papërfunduar, me burim të ardhurat nga shitja e shtëpisë dhe 1.380 m² tokë në fshatin Rrilë, Lezhë, me vlerë 1.500.000 lekë, sipas kontratës nr. 2078 rep., datë 16.09.1998.

Subjekti i rivlerësimit pranon se ky apartament është blerë pa kontratë noteriale shitblerjeje nga shtetasi P. C., ndërtuesi i pallatit në rrugën {***}, Lezhë, dhe nuk ka qenë i regjistruar në regjistrat e pasurive të paluajtshme. Në dëshminë e dhënë para Komisionit, shtetasi P. C., ndërtuesi i pallatit, deklaroi se pallatin në rrugën {***}, Lezhë, e ka shitur pa marrëveshje noteriale dhe se ky pallat nuk ka qenë asnjëherë i regjistruar në regjistrat e pasurive të paluajtshme në Lezhë, por as shtetasi P. C. dhe as subjekti nuk paraqitën ndonjë provë shkresore që vërteton se midis palëve ka ekzistuar një marrëdhënie juridike civile me qëllim kalimin e pronësisë ose të ndonjë të drejte tjetër reale, në favor të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, si dhe për pagimin real në favor të shtetasit P. C., të çmimit të pretenduar prej 1.500.000 lekësh.

38. Trupi gjykues vlerëson se sipas dispozitave të Kodit Civil, neneve 83, 164 dhe 195 dhe sipas Vendimit Unifikues nr. 1, datë 06.01.2009¹³ të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti i saj, nuk kanë asnjë dokument që të vërtetojnë pronësinë e apartamentit në rrugën {***}, Lezhë.

Pavarësisht se nuk ka pasur asnjë dokument vërtetimi pronësie, subjekti i rivlerësimit e ka shkëmbyer këtë apartament me një njësi shërbimi me sip. 150 m² dhe 25.000 euro, sipas aktmarrëveshjes nr. 860 rep., nr. 652 kol., datë 17.03.2011, me shoqërinë {***} SHPK.

Kodi Civil në nenin 757 të tij (i pandryshuar që nga hyrja në fuqi e ligjit) përcakton: “Shkëmbimi është kontrata që ka për objekt kalimin e ndërsjellë të pronësisë së sendeve ose të të drejtave të tjera nga njëri kontraktues te tjetri.”

Sa më sipër, trupi gjykues çmon se është i drejtë vendimi i Komisionit se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti i saj janë sjellë si pronarë të ligjshëm të apartamentit në rrugën {*}, Lezhë, megjithëse nuk kanë pasur asnjë akt ligjor që të vërtetojë pronësinë mbi të.**

39. Lidhur me pretendimin në ankim se është i gabuar konkluzioni i Komisionit se aktmarrëveshja nr. 860 rep., nr. 652 kol., datë 17.03.2011 me shoqërinë {***} SHPK përmban të dhëna të rreme, pasi ajo ka qenë një marrëveshje verbale paraprake “*de facto*”, e lidhur mes palëve në vitin 2010, kur

¹³ Vendimi unifikues nr. 1/2009: “Pronësia mbi një pasuri të paluajtshme kalon në çastin e lidhjes së kontratës së tjetërsimit të kësaj pasurie. Blerësi ose përfituesi i kësaj pasurie bëhet pronar i ligjshëm i saj që në momentin e nënshkrimit të kontratës duke fituar dhe të gjitha të drejtat dhe detyrimet që lidhen me qenien e tij si pronar mbi këtë pasuri. [...]” Regjistrimi ose transkriptimi i një veprimi juridik nuk është një element i vlefshmërisë së tij (kontratës). Mosregjistrimi i kontratës në regjistrat e pasurive të paluajtshme nuk e bën kontratën e tjetërsimit të pasurive të paluajtshme të pavlefshme, por nuk i jep mundësinë blerësit që ta tjetërsojë atë te të tretët. Kontrata e cila nuk është e regjistruar, është e perfeksionuar dhe e vlefshme dhe ka efektet thelbësore. Me nënshkrimin e kontratës së tjetërsimit të pasurisë së paluajtshme, përfituesi i të drejtave bëhet pronar i pasurisë së paluajtshme dhe ky legjitimohet të ushtrojë të drejtat e tij përkundëjt të tretëve, përveç tjetërsimit të pasurisë së paluajtshme në favor të të tretëve”.

është kryer edhe pagesa prej 25.000 eurosh, ndërsa me aktmarrëveshjen e shkëmbimit me shoqërinë {***} SHPK, në vitin 2011, është formalizuar marrëveshja e mëparshme, trupi gjykues konstaton se:

Në deklaratën periodike të pasurisë 2010, subjekti i rivlerësimit deklaroi shumën 25.000 euro si të ardhura nga aktmarrëveshja me shoqërinë {***} SHPK për prishjen e apartamentit të banimit në Lezhë, lëvruar me mandat pagese datë 14.05.2010.

Bashkëlidhur deklaratës së pasurisë (*vetting*) 2017, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur mandat pagese nr. 20, datë 14.05.2010, me këto të dhëna: paguar nga: F. M. ({***} SHPK); shuma lekë: 25.000 euro; paguar për prishje apartamenti sipas marrëveshjes së nënshkruar; për: A.N.. Mandat pagesa është nënshkruar nga paguesi, vulosur me vulën {***} SHPK dhe është nënshkruar nga A.N., bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit.

40. Rezulton se këto të ardhura janë marrë *cash* nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit dhe ai nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion provues që të vërtetojë marrjen e kësaj shume.

Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave, në shkresën nr. 23/1 prot., datë 22.01.2018, shprehet se: “Aktmarrëveshja nr. 860 rep., nr. 652 kol., datë 17.03.2011, shoqëruar me mandat pagesën datë 14.05.2010, e lidhur ndërmjet {***} SHPK dhe A.N. nuk rezulton të jetë raportuar”.

Aktmarrëveshja nr. 860 rep., nr. 652 kol., datë 17.03.2011, e lidhur mes A.N. dhe shoqërisë {***} SHPK, rezulton të jetë nënshkruar në vitin 2011, në ndryshim nga sa shprehet mandat pagesa, për nënshkrimin e saj që në vitin 2010. Në këtë aktmarrëveshje palët shprehen: “Palët shoqëria {***} SHPK dhe A.N., në vazhdim të marrëveshjes paraprake të bërë me gojë me të gjithë pronarët e ndërtesës për ta prishur atë, kanë rënë dakord që pjesë e këtij plani të jetë edhe apartamenti në pronësi të A.N.. Ky autorizim i dhënë nga A. N. për të prishur apartamentin e tij bëhet kundrejt shpërblimit prej një shume të hollash si më poshtë dhe fitimit të pronësisë mbi një njësi që do të ndërtohet në ndërtesën e re që shoqëria {***} SHPK i detyrohet atij”.

Për ndërtimin e godinës së re në rrugën {***}, firma {***} SHPK është pajisur me leje ndërtimi me vendimin nr. 48, datë 26.11.2009, të Bashkisë Lezhë. Sipas objektit të kontratës së shitblerjes me nr. 1371 rep, nr. 498 kol., datë 10.07.2013,¹⁴ me palë: shitës {***} SHPK dhe blerës Aleks dhe Besa Nikëhasani, për shitblerjen e njësisë me sipërfaqe 150 m² në rrugën {***} Lezhë, rezulton se kjo pronë është regjistruar në hipotekë me Certifikatë për Vërtetim Pronësie nr. {***}, datë 10.11.2011. Rezulton se në momentin e lidhjes së aktmarrëveshjes në vitin 2011, pallati në rrugën {***} për të cilin subjekti i rivlerësimit po jepte autorizim për t’u prishur - ishte prishur tashmë, sepse vetëm rreth 6 muaj më vonë nga data e lidhjes së aktmarrëveshjes, ndërtesa e re ishte e regjistruar edhe në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Lezhë.

Sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se është i drejtë konkluzioni i Komisionit se aktmarrëveshja nr. 860 rep., nr. 652 kol., datë 17.03.2011, e lidhur mes A.N. dhe shoqërisë {*} SHPK përmban të dhëna të rreme.**

¹⁴ Kjo kontratë është paraqitur nga subjekti i rivlerësimit, bashkëlidhur deklaratës së pasurisë (*vetting*) 2017.

41. Në këto kushte, trupi gjykues, pasi analizoi faktet dhe vlerësoi të gjitha provat në lidhje me pasuritë shtëpi banimi me sipërfaqe 76 m², {***}, Shëngjin, Lezhë dhe njësi shërbimi, me sipërfaqe 150 m², rruga {***}, Lezhë, arrin në përfundimin se është i drejtë vendimi i Komisionit se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar këto dy pasuri dhe ka kryer deklaram të rremë mbi të ardhurat e ligjshme, që kanë shërbyer si burim krijimi për pasuritë sipërcituar.
42. Për pasurinë, sipas deklaratës së pasurisë (*vetting*) 2017:
Autoveturë “Toyota Land Cruiser” e vitit 2012, cilindrata 2980 cc, blerë sipas kontratës nr. 792 rep., nr. 236 kol., datë 29.08.2016, me vlerë 19.500 euro, me burim të deklaruar krijimi:
a) 12.000 euro nga huaja e z. A. M., sipas kontratës së huas nr. 3833 rep., nr. 2718 kol., datë 27.08.2016;
b) 4.000 euro nga shitja e autoveturës “Toyota Land Cruiser” e vitit 1998, sipas kontratës nr. 1784 rep., nr. 572 kol., datë 15.09.2016;
c) kursimet familjare nga të ardhurat gjatë viteve 2015-2016.
43. Në lidhje me pretendimin në ankim se qëndrimi i Komisionit është paragjykes dhe në shkelje të parimit të prezumimit të pafajësisë, kur konstaton se i lind “dyshimi i arsyeshëm” për një veprim financiar të pajustificuar, pasi autovetura “Toyota Land Cruiser” e vitit 2012 i është shitur subjektit të rivlerësimit me një çmim më të ulët nga sa i ka kushtuar shitësit në të vërtetë, pasi diferenca në çmim është pasojë e defekteve të makinës, trupi gjykues konstaton se:
Sipas kontratës së shitblerjes së automjetit “Toyota Land Cruiser” nr. 792 rep., nr. 236 kol., datë 29.08.2016, me vlerë 19.500 euro, e paraqitur nga subjekti i rivlerësimit, bashkëlidhur deklaratës së pasurisë (*vetting*) 2017, rezulton se pala blerëse A.N. ka deklaruar se e njeh dhe e pranon tërësisht gjendjen faktike, fizike dhe juridike të mjetit dhe dëshiron ta marrë në pronësi.
Nga të dhënat e Drejtorisë Rajonale të Shërbimeve të Transportit Rrugor, Tiranë, sipas shkresës nr. 15510/1 prot., datë 23.12.2017, rezulton se çmimi i shitjes së automjetit është 23.900 euro, ndërsa në doganë, në datën 13.08.2016 është paguar një shumë detyrimi për zhdoganimin e automjetit në vlerën 659.110 lekë. Pra, vlera e automjetit (e konvertuar sipas vlerës në lekë të euros në periudhën në fjalë) është 3.909.510 lekë, pas zhdoganimit, duke pasur një diferencë në çmim prej 1.257.510 lekë nga çmimi i paguar në kontratën e shitjes, prej blerësit A.N..
Subjekti i rivlerësimit këtë diferencë të pajustificuar e shpjegon me defekte të automjetit. Por, sipas fotografive të telefonit celular dërguar me *sms* nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit te pala shitëse e automjetit, defektet e tij datojnë në vitin 2017 pra, rreth një vit më vonë nga data e blerjes së mjetit, duke hedhur poshtë justifikimin e subjektit të rivlerësimit për diferencën në çmimin e blerjes me atë të shitjes së automjetit, për shkak të defekteve të automjetit në momentin e blerjes së tij.
Sa më sipër, trupi gjykues çmon se është i drejtë konkluzioni i Komisionit se shitja e autoveturës “Toyota Land Cruiser” subjektit të rivlerësimit me një çmim më të ulët nga sa i ka kushtuar shitësit në të vërtetë përbën një veprim financiar të pajustificuar.

44. Në lidhje me pretendimin në ankim se është i gabuar konkluzioni i Komisionit se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarim të rremë dhe ka burim të pajustificuar të ardhurash për shumën 4.000 euro të përfituar nga shitja e autoveturës së vjetër, pasi subjekti i rivlerësimit ka provuar me deklaratë noteriale, por edhe me parashikimet kontraktore se autovetura është shitur para blerjes së autoveturës së re “Toyota Land Cruiser”, por formalizimi është bërë në një periudhë të mëvonshme, trupi gjykues konstaton se:

Subjekti i rivlerësimit, në deklaratën e pasurisë (*vetting*) 2017, ka deklaruar vlerën prej 4.000 eurosh të përfituar nga shitja e automjetit të vjetër, si burim të ardhurash për blerjen e automjetit “Toyota Land Cruiser”.

Sipas kontratës së shitjes së automjetit nr. 1784 rep., nr. 572 kol., datë 15.09.2016¹⁵ mes palëve: shitës A.N. dhe blerës Shoqëria {***} SHPK, shitësi ka dorëzuar automjetin dhe blerësi e ka marrë në dorëzim në gjendjen në të cilën e ka pëlqyer, ditën e lidhjes së kësaj kontrate dhe çmimi i shitjes është caktuar të jetë 4.000 euro. Në këtë kontratë shitjeje, palët shprehen se shuma e shitjes është likuiduar nga palët përpara nënshkrimit të kontratës, por nuk referohet prej tyre asnjë datë e saktë për lëvrimin e kësaj shume, e cila nuk rezulton të vërtetohet se është paguar, me asnjë dokument shkresor.

Për të vërtetuar se çmimi i shitjes së automjetit është likuiduar më datë 22.07.2016, pra përpara blerjes së automjetit të ri, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur deklaratën noteriale nr. 837 rep., nr. 264 kol., datë 26.03.2018, të shoqërisë {***} SHPK dhe A.N., në të cilën palët deklarojnë se automjeti është marrë në dorëzim dhe është likuiduar nga blerësi që në datën 22.07.2016, por kontrata për shitblerjen është formalizuar më vonë për shkak të angazhimeve të personale të palëve. Vërtetësinë e deklarimeve dhe shprehjes së vullnetit të tyre në këtë kontratën e lidhur mes tyre në datë 15.09.2016 për shitjes së automjetit, palët e rrëzojnë me një deklaratë noteriale të datës 26.03.2018.

45. Subjekti i rivlerësimit pretendon se e kishte dorëzuar automjetin e vjetër te pala blerëse që në muajin korrik 2016, sepse për këtë arsye kishte marrë hua një mjet tjetër për dy javë me kontratë huapërdorjeje automjeti nr. 1522 rep., nr. 838 kol., datë 14.08.2016. Deklarata noteriale e huapërdorjes e sipërcituar është redaktuar pranë noterit publik S. R., në Pogradec.

Në shpjegimet e subjektit të rivlerësimit në përgjigje të pyetësorit të Komisionit, datë 15.12.2017, pyetjes së Komisionit: “A keni përdorur në shtatë vitet e fundit pasuri të peregjistruara në emrin e dikujt tjetër (si: automjete, shtëpi, anije, apartamente, shtëpi pushimi etj.)?” - subjekti i rivlerësimit i përgjigjet: “Vetëm në një rast kemi marrë një automjet dhe e kemi mbajtur për pesë ditë, konkretisht ka ndodhur vjet, më datë 15.08.2016, kur ishim nisur për pushime në Greqi, dhe në Pogradec na u difektua automjeti ynë. Të ndodhur në këto kushte, kemi marrë automjetin e një të njohuri të bashkëshortit tim, nga Pogradeci, të quajtur Y. M.”.

¹⁵ Kjo kontratë është paraqitur nga subjekti i rivlerësimit, bashkëlidhur deklaratës së pasurisë (*vetting*).

Pra, provohet se subjekti i rivlerësimit nuk e kishte shitur automjetin e vjetër dhe, për pasojë, nuk mund të dispononte shumën 4000 euro, të cilën e pretendon si burim të ardhurash për automjetin tip “Toyota Land Cruiser”.

Sa më sipër, trupi gjykues e vlerëson të drejtë vendimin e Komisionit se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të rremë dhe ka mungesë dokumentacioni ligjor për të justifikuar burimin e shumës 4000 euro për blerjen e automjetit.

46. Në lidhje me pretendimin në ankim se në kundërshtim nga sa ka konkluduar Komisioni, shtetasi A.M. ka mundësi financiare për t'i dhënë hua subjektit të rivlerësimit, në shumën 12.000 euro, trupi gjykues konstaton se:

Sipas dokumentit kontratë huaje nr. 3833 rep., nr. 2718 kol., datë 27.08.2016, e paraqitur nga subjekti i rivlerësimit bashkëlidhur deklaratës së pasurisë (*vetting*) 2017, rezulton se bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit A.N. ka marrë hua një shumë prej 12000 eurosh për blerjen e një makine nga shtetasi A.M. për një afat 24 mujor, pa interes, me të drejtë shtyrje afati për shlyerjen.

Në këtë kontratë huaje palët nuk shprehen për mënyrën e lëvrimit të shumës objekt kontrate dhe subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur asnjë dokument justifikues për të provuar lëvrimin e kësaj shume.

Sipas shkresës së Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave nr. 23/1 prot., datë 22.01.2018, si burim të shumës së dhënë hua, me kontratën e huas së sipërcituar, shtetasi A. M. rezulton të ketë deklaruar: “Të ardhura nga kursimet familjare dhe puna”.

Bazuar në të dhënat e Drejtorisë Rajonale Tatimore Lezhë, sipas shkresës nr. 517/1 prot., datë 30.01.2018, rezulton se shtetasi A.M. është administrator i shoqërisë {***} SHPK, me aktivitet agent i transferimit të parave me, dhe për llogari të subjektit financiar jo-Bankë. Ky subjekt është regjistruar në organet tatimore më datë 16.04.2007, nuk ka detyrime të palikuiduara, nuk ka dividendë të tërhequr. Për periudhën 2007-2013, nuk rezultojnë të dhëna të regjistruara.

Sipas informacionit të përgjithshëm të sistemit C@TS të tatimeve, shoqëria {***} SHPK, në termat e analizës financiare, rezulton me detyrime në shumën 3.432.205.92 lekë (pa konsideruar shpenzimet korrente).

Sipas të dhënave të Institutit të Sigurimeve Shoqërore, sipas shkresës nr. 6438/1 prot., datë 25.02.2017, për të ardhurat financiare bruto dhe neto të realizuara sipas viteve të punës, rezulton se nga viti 2012 deri në vitin 2016, paga neto e A.M. ka qenë 29.985 lekë në muaj.

Bazuar në sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se A.M., nuk ka pasur mundësi financiare të japë hua në shumën 12.000 euro, nga të ardhurat nga puna, në kundërshtim me sa ka deklaruar ai përpara noterit publik, në momentin e nënshkrimit të dokumentit kontratë huaje nr. 3833 rep., nr. 2718 kol., datë 27.08.2016.

47. Subjekti i rivlerësimit në mbështetje të pretendimeve të tij se A. M. paratë e dhëna hua nuk i ka nga aktiviteti i tij tregtar, ka paraqitur deklaratën noteriale nr. 654 rep., nr. 458 kol., datë 19.02.2018 të shtetasis A.M., i cili deklaroi se shumën 12.000 euro, të cilën ia ka dhënë hua A.N. (bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit) e ka pasur gjendje nga paratë që i ka pas marrë hua

shtetasit A.M. sipas deklaratës noteriale nr. 17 rep., nr. 09 kol., datë 05.01.2016. A.M., sipas dëshmisë së dhënë prej tij në Komision në datë 27.02.2018, deklaroi se shumën e dhënë hua nuk e ka krijuar si pasojë e aktivitetit të tij tregtar, por e ka pasur gjendje nga një hua që ia ka marrë kushëririt të tij A.M., emigrant në Greqi.

Këto deklarime të mëvonshme të A.M. bien në kundërshtim me atë që është raportuar nga Drejtoria e Parandalimit dhe Pastrimit të Parave, sipas së cilës A.M. në momentin e lidhjes së kontratës së huas me A.N. ka deklaruar se shuma prej 12.000 eurosh përbëhet nga të ardhurat e tij nga puna dhe kursimet familjare.

48. Në deklaratë noteriale nr. 17 rep., nr. 09 kol., datë 05.01.2016, palët A. M. në cilësinë e huadhënësit dhe A.M. në cilësinë e huamarrësit, deklarojnë se A.M. i ka dhënë borxh një shumë parash prej 50.000 eurosh, pa interes, A.M., të cilat ia ka kaluar me bankë, me një afat kthimi deri më datën 05.01.2017, afat i cili në mirëkuptim me njëri-tjetrin mund të zgjatet dhe mund të shkurtohet nëpërmjet një akti të shkruar.

Sipas këtyre deklaratave noteriale, rezulton se A.M., detyrimin për kthimin e shumës 50.000 euro e ka pasur për një vit, deri më datë 5.01.2017, ndërkohë një pjesë të kësaj shume e ka dhënë hua te një person i tretë me afat kthimi deri më 27.08.2018, shumë kohë më vonë se afati i detyrimit që ka ai ndaj palës së cilës i ka marrë borxhin (A. M.) dhe me të cilën nuk rezulton se ka një akt të shkruar për zgjatjen e afatit sipas deklaratës noteriale nr. 17 rep., nr. 09 kol., datë 05.01.2016.

Subjekti i rivlerësimit pretendon se shuma prej 50.000 eurosh është kaluar me bankë nga Artan Marku tek A.M. nëpërmjet urdhërshirimit të Bankës Credins, datë 5.01.2016. Urdhëruesi i shumës 50.000 euro është L.M. ose J.M.. Përshkrimi i këtij urdhërshirimi është në kundërshtim me deklaratën noteriale nr. 17 rep., nr. 09 kol., datë 5.01.2016, në të cilën A.M. deklaroi se është paraqitur personalisht përpara noterit, duke deklaruar se ai ia ka kaluar me bankë shumën huamarrësit A.M..

Përmbajtja e këtij urdhërshirimi bie në kundërshtim me përmbajtjen e deklaratave noteriale të datës 5.01.2016 dhe 19.02.2018 të A.M., sipas të cilave borxhin ia ka dhënë A.M.. Për shkak se deklaruesit mbajnë qëndrime të kundërta në deklaratat noteriale të sipërcituara, si dhe për shkak se subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur asnjë dokument justifikues për vërtetimin e marrjes prej tij të shumës prej 12.000 eurosh, nuk provohet ligjshmëria e burimit të këtyre të ardhurave.

Sa më sipër, trupi gjykues e vlerëson të drejtë konkluzionin e Komisionit se shtetasi A.M. nuk ka pasur mundësi financiare për t'i dhënë hua bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit në shumën 12.000 euro.

49. *Lidhur me pretendimin në ankim se qëndrimi i Komisionit, i cili nuk merr parasysh deklaratimet e personave para noterit publik, duke mos i dhënë kështu nivelin e provueshmërisë, madje duke analizuar një transaksion tjetër, atë mes huadhënësit dhe palëve të treta, është tërësisht i njëanshëm dhe në shkelje të hapur të parimeve bazë, të procedurave të ndjekura dhe lirive e të drejtave themelore të njeriut, trupi gjykues konstaton se:*

Neni 30 i ligjit nr. 84/2016 përcakton objektin e vlerësimit të pasurisë, duke e shtrirë deklarin dhe kontrollin e pasurive, ligjshmërinë e burimit të krijimit të tyre, përmbushjen e detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë edhe për personat e lidhur të subjektit të rivlerësimit.

A.N., bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, ka lidhur kontratë huaje nr. 3833 rep., nr. 2718 kol., datë 27.08.2016, me shtetasin A.M.. Nëpërmjet kësaj deklarate noteriale, në kuptim të pikës 14¹⁶ të nenit 3 të ligjit të sipërcituar, A.M. hyn në rrethin e personave të tjerë të lidhur me subjektin e rivlerësimit.

Bazuar në urdhërimin ligjor të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, e cila përcakton se: “4. Subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, ose persona të tjerë të lidhur, të deklaruar në cilësinë e dhuruesit, huadhënësit ose huamarrësit, nëse konfirmojnë këto marrëdhënie, kanë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive.” - shtetasi A.M. mbart detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurisë, shumës 12.000 euro, të cilën ia ka dhënë hua bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit.

50. Trupi gjykues vlerëson se procedura e ndjekur nga Komisioni për hetimin e burimit të krijimit të pasurisë së shtetasit A.M. është në përputhje të plotë me nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016 dhe me vendimin nr. 2/2017 të Gjykatës Kushtetuese, i cili në paragrafin 38, shprehet: “Sipas nenit 45 të ligjit anëtarët e KPK-së, gjyqtarët e KA-së dhe vëzhguesit ndërkombëtarë hetojnë dhe vlerësojnë të gjitha faktet dhe rrethanat e nevojshme për procedurën e rivlerësimit dhe gjatë hetimit administrativ mund të kërkojnë informacion nga çdo subjekt i së drejtës publike. Ata administrojnë dokumentet që vërtetojnë veprime, fakte, cilësi ose një situatë subjektive të nevojshme për realizimin e hetimit. Kjo dispozitë lejon që këto institucione të hetojnë në mënyrë të pavarur për të gjitha rrethanat e çështjes. Sipas nenit 50 institucionet e rivlerësimit bashkëpunojnë me organet shtetërore, personat fizikë dhe juridikë, vendas ose të huaj, për të verifikuar vërtetësinë dhe saktësinë e deklaramëve të bëra nga subjektet e rivlerësimit [...]”.

Sa më sipër, pretendimi i subjektit të rivlerësimit është i pabazuar.

51. *Lidhur me pretendimin në ankim se është i gabuar konkluzioni i Komisionit se subjekti i rivlerësimit ka kryer fshehje të pasurisë në shumën prej 200.000 lekësh dhe ka kryer deklarin të rremë në lidhje me huadhënien prej 300.000 lekë, pasi qëllimi nuk ka qenë fshehja e pasurisë, por mosdeklarimi i tyre është pasojë e harresës, trupi gjykues konstaton se:*

Në deklaratën periodike të pasurisë 2003, subjekti i rivlerësimit deklaroi si pasuri një automjet tip Golf 1.4, Model 3, viti i prodhimit 1993 (duke deklaruar dhe targat e automjetit) me vlerë 400.000 lekë, e blerë me kursime familjare (Formulari A2 i deklarinimit).

Në deklaratën periodike të pasurisë 2004, deklaroi të njëjtin automjet, por me vlerë 500.000 lekë.

¹⁶ Neni 3, pika 14 e ligjit nr. 84/2016:

“14. “Persona të tjerë të lidhur” janë personat fizikë ose juridikë, që duket se kanë ose kanë pasur lidhje interesi me subjektin e rivlerësimit, komisionerin, gjyqtarin ose komisionerin publik që rrjedh nga një interes pasuror ose çdo marrëdhënie tjetër biznesi”.

Në deklaratimet e viteve të mëvonshme është deklaruar shitja dhe blerja e automjeteve të tjera, por nuk është deklaruar më asnjë veprim në lidhje me automjetin në fjalë.

Nga të dhënat e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Transportit Rrugor, sipas shkresës nr. 1514/6 prot., datë 16.02.2018, nga dosja e plotë e automjetit me targë sipas deklaratimit të subjektit të rivlerësimit në vitet 2003 dhe 2004, rezulton se bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit e ka fituar pronësinë e këtij automjeti me anë të një kontrate dhurimi automjeti, me nr.1020 rep., nr. 408 kol., datë 25.08.2001, në kundërshtim me sa ka deklaruar në deklaratimet vjetore periodike 2003 dhe 2004.

Sipas dosjes së mjetit cituar si më sipër, kjo makinë është shitur nga A.N. me kontratën nr. 1415 rep., nr. 612 kol., datë 21.05.2008 te shtetasi G. P. në vlerën 200.000 lekë. Në deklaratën e pasurisë (*vetting*) 2017 dhe në deklaratën periodike të pasurisë 2008 është fakt se nuk është deklaruar shitja e këtij automjeti.

Sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se është i drejtë vendimi i Komisionit se subjekti i rivlerësimit ka kryer fshehje pasurie në shumën 200.000 lekë.

52. *Në lidhje me shumën 300.000 lekë e dhënë hua nga subjekti i rivlerësimit në vitin 2007, trupi gjykues konstaton se:*

Në deklaratën periodike të pasurisë 2007, subjekti i rivlerësimit deklaroi se i ka dhënë hua shtetasit P.N. (kuntatit) një shumë prej 300.000 lekësh, pa cituar asnjë dokumentacion që të vërtetojë këtë fakt të pretenduar. Në deklaratimet e mëpasshme të pasurisë nuk ka deklaruar mbi kthimin e kësaj shume nga P.N. dhe as në deklaratën e pasurisë (*vetting*) 2017 nuk ka deklaruar mbi këtë huadhënie. Për vitin 2007, trupit gjykues siç ka analizuar në paragrafin 28 i rezulton se subjekti nuk mund të jepte hua shumën 300.000 lekë, kthimin e së cilës nuk e ka deklaruar në asnjë nga deklaratat e mëvonshme.

Sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se është i drejtë vendimi i Komisionit se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarim të rremë në lidhje me huadhënien.

53. *Në lidhje me pretendimin në ankim se subjekti i rivlerësimit nuk është në kushtet e tejkalimit të dyfishit të pasurisë së ligjshme, trupi gjykues, pasi analizoi të gjitha faktet që kanë rëndësi për çështjen si dhe vlerësoi të gjitha provat, në lidhje me pasuritë e krijuara nga subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të, nga viti 2003-2016, arrin në konkluzionin se:*

- a) apartamenti i banimit në Shëngjin, Lezhë, ka burim të pajustificuar në vlerën 25.000 euro (3418.000 lekë), pasi subjekti nuk ka pasur asnjëherë dokument pronësie për apartamentin në rr. {***}, të cilin pretendon ta ketë shkëmbyer në vlerën e mësipërme;
- b) njësia e shërbimit 150 m² në rr. {***}, Lezhë, ka burim të pajustificuar, në vlerën 6.000.000 lekë, pasi subjekti nuk ka pasur asnjëherë dokument pronësie për apartamentin në rr. {***}, të cilin pretendon ta ketë shkëmbyer me këtë njësi shërbimi;
- c) apartamenti i banimit në rr. {***}, Tiranë, ka burim të pajustificuar, në vlerën 4.749.349 lekë, pasi subjekti i rivlerësimit nuk kishte mundësi të kursente këtë shumë për periudhën 2007-2011;

ç) autovetura tip “Toyota Land Cruiser” ka burim të pajustificuar në vlerën 16.000 euro (2.184.160 lekë), pasi rezulton se zoti A. M nuk ka mundësi financiare për të justifikuar dhënien e një huaje në vlerën 12.000 euro dhe subjekti i rivlerësimit ka mungesë të dokumentacionit ligjor për të justifikuar burimin e shumës 4.000 euro për blerjen e automjetit.

54. Rezulton se raporti i pasurisë së ligjshme me pasurinë e deklaruar në deklaratën e pasurisë (*vetting*) 2017 është si më poshtë:

Pasuria e subjektit të rivlerësimit më datë 31.12.2016 rezulton të jetë: 24.637.339 lekë;

Pasuria e analizuar dhe e arsyetuar si e ligjshme në termat ligjorë dhe ekonomikë rezulton të jetë: 8.772.156 lekë;

Treguesi i Vlerësimit të Pasurisë i matur si raport i Pasurisë së subjektit të rivlerësimit sipas deklaratës së pasurisë (*vetting*) 2017 me pasurinë e ligjshme është 2,8 herë (më i madh).

Trupi gjykues, në analizë të sa më sipër, bazuar në nenin D, pika 4 e Aneksit të Kushtetutës, e cila përcakton: “4. Nëse subjekti i rivlerësimit ka një pasuri më të madhe se dyfishi i pasurisë së ligjshme, ai prezumohet fajtor për shkeljen disiplinore, përveçse kur ai paraqet prova që vërtetojnë të kundërtën”, si dhe në nenin 61, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, e cila parashikon se: “Shkarkimi nga detyra i subjektit të rivlerësimit jepet si masë disiplinore në këto raste: 1. Kur rezulton se ka deklaruar më shumë se dyfishi i pasurisë së ligjshme gjatë vlerësimit të pasurisë, përfshirë edhe personat e lidhur me të.”, për sa i përket masës disiplinore të dhënë nga Komisioni me vendimin nr. 15, datë 20.04.2018, çmon se ky vendim duhet lënë në fuqi.

55. **Subjekti i rivlerësimit rezulton se ka kryer deklaram të pamjaftueshëm për kontrollin e pasurisë, sepse:**

Deklarimi nuk është i saktë dhe në përputhje me ligjin.

Subjekti në mënyrë të përsëritur ka kryer gabime dhe pasaktësi në deklarime.

Nuk ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë.

Ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për pasuritë që ka në pronësi, mungesë të dokumentacionit ligjor për pronësinë e këtyre burimeve të pretenduara.

Ka kryer fshehje të pasurisë.

Ka kryer deklaram të rremë.

56. **Trupi gjykues, bazuar në nenin D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, e cila përcakton se subjekti i rivlerësimit duhet të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave, si dhe në nenin 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, e cila parashikon se shkarkimi nga detyra i subjektit të rivlerësimit jepet si masë disiplinore, kur rezulton se ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për kriterin e pasurisë, sipas parashikimeve të nenit 33 të këtij ligji, për sa i përket masës disiplinore të dhënë nga Komisioni me vendimin nr. 15, datë 20.04.2018, çmon se ky vendim duhet lënë në fuqi.**

57. **Kolegji i Posaçëm i Apelit, pasi e shqyrtoi çështjen në tërësi, mbi bazën e parimeve të barazisë para ligjit, kushtetutshmërisë e ligjshmërisë, proporcionalitetit, parime këto që garantojnë të drejtën e subjektit të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor, bazuar në arsyet e parashtruara**

më lart, vlerëson se vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 12, datë 23.03.2018, është i drejtë dhe duhet lënë në fuqi.

PËR KËTO ARSYE,

trupit gjykues, bazuar në nenin 66, pika 1, germa “a” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

VENDOSI:

1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 15, datë 20.04.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit që i përket subjektit të rivlerësimit Besa Nikëhasani.
2. Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi menjëherë.
3. U shpall sot në Tiranë, më datë 12.09.2018.

ANËTAR

Ardian HAJDARI
nënshkrimi

ANËTARE

Natasha MULAJ
nënshkrimi

ANËTARE

Rezarta SCHUETZ
nënshkrimi

RELATORE E ÇËSHTJES

Albana SHTYLLA
nënshkrimi

KRYESUES I TRUPIT GJYKUES

Sokol ÇOMO
nënshkrimi